

GJENDJA E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOMUNAT E KOSOVËS

RAPORT I HULUMTIMIT MBI GJENDJEN E KOMUNITETEVE
ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË FUSHËN E ARSIMIT
DHE PUNËSIMIT NË GJASHTË (6) KOMUNA TË KOSOVËS:

Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë,
Gjakovë, Lipjan dhe Prizren



GJENDJA E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOMUNAT E KOSOVËS

**RAPORT I HULUMTIMIT MBI GJENDJEN E KOMUNITETEVE
ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË FUSHËN E ARSIMIT
DHE PUNËSIMIT NË GJASHTË (6) KOMUNA TË KOSOVËS:**

**Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë,
Gjakovë, Lipjan dhe Prizren**

**Raport i hulumtimit mbi gjendjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës:
Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Gjakovë, Lipjan dhe Prizren**

Hartimit të këtij raporti i kontribuan:
Ema Rraci, Kushtrim Bajrami, Alisa Hasani

Dhjetor 2018
Prishtinë

Publikuar nga Projekti “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN”
Për më shumë informata: www.keen-ks.net

Design: **envinion**



Ky raport është përgatitur me përkrahjen e projektit “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Ky projekt zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), në bashkëpunim me Agjencinë për Promovimin e Punësimit në Kosovë (APPK), Balkan Sunflowers Kosovo (BSFK), Akademinë për Trajnim dhe Asistencë Teknike (ATTA) dhe Stichting SPARK. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE	6
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
2. HYRJE.....	9
3. QËLLIMI I HULUMTIMIT.....	10
4. METODOLOGJIA.....	11
5. ROMËT, ASHKALINJTË DHE EGJIPTIANËT NË SISTEMIN ARSIMOR.....	14
5.1. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Ferizajt.....	16
5.2. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës.....	22
5.3. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Gracanicës.....	26
5.4. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Gjakovës	30
5.5. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit	34
5.6. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Lipjanit	38
6. QENDRAT MËSIMORE.....	42
7. PUNËSIMI DHE MIRËQENIA SOCIALE	52
8. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	58
8.1. Rekomandimet	59
SHTOJCA 1. LISTA E SHKOLLAVE TË PËRFSHIRA NË HULUMTIM	62

LISTA E SHKURTESAVE

APRK	Agjencia për Punësim e Kosovës
EPMPB	Ekipet për parandalimin dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsim të detyrueshëm
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KEEN	Projekti Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
PATP	Politikat Aktive të Tregut të Punës
PLV	Planet Lokale të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian
PSAK	Plani Strategjik për Arsim në Kosovë 2017 - 2021
QAP	Qendrat e Aftësimi Profesional
SNS	Skema e Ndhmës Sociale
ZKKK	Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet një vlerësim të përgjithshëm të pjesëmarrjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, në fushën e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale në gjashtë komunat e Kosovës, përfshirë komunën e Ferizajt, Fushë Kosovës, Graçanicës, Gjakovës, Lipjanit dhe Prizrenit. Për më shumë, ky hulumtim identifikon sfidat, vështirësitë, problemet si dhe zhvillimet pozitive në përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale në këto komuna.

Gjatë periudhës 2017 – 2018, Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN” ka mbështetur komunat e lartcekura në hartimin e Planeve Lokale të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian (PLV), me synimin që këto plane lokale strategjike do të zbatohen dhe do të reflektojnë pozitivisht në përfshirjen e komuniteteve në këto komuna. Në këtë drejtim, ky hulumtim paraqet një pikënisje të monitorimit të zbatimit të planeve lokale të veprimit për komunitete në këto gjashtë komuna dhe përfshin aspekte të rëndësishme të sektorëve të arsimit parauniversitar dhe punësimit në këto gjashtë komuna (kryesisht çështjet që kanë qenë të përfshira edhe në kuadër të PLV-ve).

Për realizimin e këtij hulumtimi është përzgjedhur një mostër mjaft e madhe nga gjashtë komunat e përfshira në hulumtim. Komunat e përzgjedhura, janë gjashtë komunat e Kosovës me numrin më të madh të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe për këtë arsye mund të thuhet se të dhënat e mbledhura në këto komuna, pasqyrojnë gjendjen e përgjithshme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

Me qëllim të eksplorimit të çështjeve dhe aspekteve të përfshira në hulumtim nga perspektiva të ndryshme, janë zhvilluar intervista me akterë të sektorëve dhe niveleve të ndryshme të arsimit parauniversitar dhe punësimit të këtyre gjashtë komunave, përfshirë, përfaqësues të zyrave komunale për komunitete dhe kthim, drejtorë të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta (përfshirë gjimnazet dhe shkollat e mesme profesionale), si dhe mësimdhënës nga të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, përfshirë mësimdhënës nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Disa nga të gjeturat kryesore të këtij hulumtimi janë si në vijim:

- Niveli i përfshirjes së fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parashkollor vazhdon të jetë i ulët. Ndonëse ka përmirësim sa i përket pjesëmarrjes në arsimin e detyrueshëm, pjesëmarrja shkon duke u zvogëluar në nivelet më të larta të sistemit të arsimit.
- Përveç nivelit jo të kënaqshëm të përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelet e edukimit parashkollor, arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të lartë, një shqetësim tjetër është suksesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë.

- Fenomeni i braktisjes së shkollimit vazhdon të jetë prezent në komunat e Kosovës. Në këtë drejtim, shumë nga komunat nuk kanë hartuar ende plane për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit dhe në shumë komuna EPRMB nuk janë ende funksionale.
- Trajnimet e vazhdueshme sigurojnë që mësimeve vazhdimisht zhvillohen për të zbatuar metoda atraktive dhe për të siguruar gjithëpërfshirjen në klasë. Megjithatë, shqetësues është fakti që pothuajse vetëm gjysma e të gjithë mësimeve pjesëmarrës në këtë hulumtim kanë ndjekur trajnime për mësime në klasë diverse, kuptimin e kulturave të ndryshme dhe qasje ndaj nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- Papunësia në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është shumë e lartë, krahasuar me komunitetet tjera.
- Mungesa e kualifikimeve rëndon nivelin e lartë të papunësisë tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian rradhët. Në këtë drejtim, të dhënat tregojnë se nga numri i punëkërkuarve rom, ashkali dhe egjiptian, të regjistruar në vitin 2018, 55% prej tyre janë të pakualifikuar, dhe 30% me arsim fillor. Trendi i përfshirjes së pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në aftësim profesional po ashtu ka pësuar rënie drastike në dy vitet e fundit (61.5%).

2. Hyrje

Të dhënat e regjistrimit të popullsisë së Kosovës në vitin 2011, tregojnë se 8,824 ose 0.5% e popullsisë së përgjithshme janë romë, 15,436 ose 0.9% e popullsisë së përgjithshme janë ashkali dhe 11,526 ose 0.7% e popullsisë janë egjiptian.¹ Sipas këtyre të dhënave, 2.1% e popullsisë i përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Numri më i madh i këtyre komuniteteve, rreth 61% jetojnë në Gjakovë, Fushë Kosovë, Prizren, Ferizaj, Lipjan dhe Graçanicë.

Sa i përket arsimimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, të tri këto komunitete përballen me sfida përafërsisht të ngjashme, të karakterizuara me kushte të vështira socio-ekonomike dhe përfshirje të ulët në arsim dhe punësim. Mungesa e përfshirjes në arsim, dhe rrjedhimisht mos-arritja e kualifikimeve të duhura, bashkë me faktorë tjerë të jashtëm, ndikojnë negativisht në përfshirjen këtyre komuniteteve në tregun e punës.

Në këtë drejtim, me qëllim të forcimit të karakterit multi-etnik dhe multi-kulturor të shoqërinë kosovare, në prill të vitit 2017, Qeveria e Kosovës aprovoi Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 - 2021, si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj. Kjo strategji identifikon arsimin, punësimin dhe mirëqenien sociale, shëndetësinë dhe banimin si katër fusha të rëndësishme të veçantë për përfshirjen e këtyre komuniteteve. Secila nga këto fusha ka të përcaktuar objektivat strategjik dhe masat për arritjen e këtyre objektiveve.

Megjithatë, një vit e gjysmë pas aprovimit të kësaj strategjie, zbatimi i saj mbetet larg përmbushjes së masave dhe aktiviteteve të përcaktuara, ndërsa arsye të ngecjes së zbatimit të kësaj strategjie mbeten të shumta, duke filluar nga mungesa e angazhimit politik, e deri tek mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore për zbatim të saj.² Për më shumë, përfshirja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me fokus të veçantë në rritjen e përfshirjes së tyre në fushën e arsimit është përcaktuar edhe në Planin Strategjik për Arsim në Kosovë (PSAK) 2017-2021, i aprovuar në dhjetor të vitit 2016.

Një zhvillim pozitiv në nivel lokal ishte hartimi i Planeve Lokale të Veprimit në një numër të madh të komunave, të mbështetura kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile. Në kuadër të Planeve Lokale të Veprimit, komunat kanë përcaktuar objektivat e tyre strategjik, masat dhe buxhetin për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara.

1 ASKDATA - <http://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/?rxid=Ob4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/>

2 KFOS, Raport Vlerësimi: Zbatimi i Strategjisë Për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017, Dhjetor 2017.

3. Qëllimi i hulumtimit

Siç është përmendur në pjesën hyrëse të këtij raporti, Projekti “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN”³ ka përkrahur gjashtë (6) komuna të ndryshme të Kosovës, përkatësisht komunën e Ferizajt, Fushë Kosovës, Graçanicës, Gjakovës, Lipjanit dhe Prizrenit në hartimin e Planeve Lokale të Veprimit (PLV) për periudhën pesëvjeçare. PLV-të e shumicës së komunave janë paraparë të zbatohen gjatë periudhës 2018 – 2022, prandaj dhe viti 2018 ka qenë viti i parë i zbatimit të PLV-ve në shumicën e këtyre komunave.

Projekti KEEN në kuadër të aktiviteteve të veta e ka të paraparë që të realizojë monitorim vjetor të zbatimit të këtyre PLV-ve nga komunat dhe ndikimin e zbatimit të tyre. Mirëpo, meqë viti 2018 ka qenë viti i parë i zbatimit të këtyre planeve, në mes të vitit 2018 (kur është realizuar ky hulumtim) ka qenë e pamundur që të monitorohet zbatimi i tyre, meqë ende nuk ka kaluar as gjysmë viti që nga fillimi i zbatimit të tyre, prandaj ka qenë e pamundur që të monitorohet niveli i zbatimit të tyre dhe ndikimi i zbatimit të tyre në mes të vitit 2018.

Për këtë qëllim, Projekti KEEN ka vendosur që gjatë vitit 2018 të realizojë një hulumtim i cili paraqet një vlerësim të gjendjes së përgjithshme të përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe analizon çështje të rëndësishme të sektorëve të arsimit parauniversitar dhe punësimit në këto gjashtë komuna (kryesisht aspektet që kanë qenë të përfshira edhe në kuadër të PLV-ve). Në këtë drejtim, ky hulumtim ka për qëllim që t’u shërbejë këtyre gjashtë komunave si orientim se ku t’i përqendrojnë burimet dhe energjitë e tyre në funksion të adresimit të sfidave dhe problemeve më të mëdha në përfshirjen e komuniteteve në komunën e tyre.

Për më shumë, ky hulumtim paraqet vetëm një pikënisje të vlerësimit të zhvillimeve në përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit, punësimit dhe mirëqenies social, ndërkaq në vitet në vijim, Projekti KEEN do të realizoj monitorim vjetor të zbatimit të PLV-ve në gjashtë (6) komunat e Kosovës, përfshirë komunën e Ferizajt, Fushë Kosovës, Graçanicës, Gjakovës, Lipjanit dhe Prizrenit.

3 Projekti “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN” është projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Ky projekt zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), në bashkëpunim me Agjencinë për Promovimin e Punësimit në Kosovë (APPK), Balkan Sunflowers Kosovo (BSFK), Akademinë për Trajnim dhe Asistencë Teknike (ATTA) dhe Stichting SPARK.

4. Metodologjia

Për realizimin e këtij hulumtimi është përzgjedhur një mostër e larmishme nga gjashtë komunat e përfshira në hulumtim (Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Gjakovë, Prizren dhe Lipjan). Me qëllim të eksplorimit të çështjeve dhe aspekteve të përfshira në hulumtim nga kënde dhe perspektiva të ndryshme, në kuadër të mostrës së këtij hulumtimi janë përfshirë shumë akterë të sektorëve dhe niveleve të ndryshme të arsimit parauniversitar të këtyre gjashtë komunave.

MË KONKRETISHT, SI MOSTËR TË PËRFSHIRË NË KËTË HULUMTIM NGA KËTO GJASHTË KOMUNA KANË QENË GJITHSEJ 218 PERSONA TË NDARË SI NË VIJIM:

6 ZYRTARË

të Zyrës për Komunitete dhe Kthim (ZKKK);

32 MËSIMDHËNËS

të shkollave të mesme të larta;

40 DREJTORË

të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta;

6 MËSIMDHËNËS

nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

134 MËSIMDHËNËS

të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta;

Personat e përzgjedhur si mostër për këtë hulumtim kanë qenë me karakteristika të ndryshme, përkatësisht nga të dy gjinitë, të moshave të ndryshme, nga shkolla të ndryshme (urbane dhe rurale, të vogla dhe të mëdha) etj.

Për realizimin e hulumtimit dhe mbledhjen e të dhënave janë përgatitur pyetësorë të ndryshëm, përmes të cilëve është realizuar intervistimi i personave të përfshirë në hulumtim. Intervistat janë realizuar nga hulumtues me përvojë dhe të cilët janë trajnuar posaçërisht për nevoja të këtij hulumtimi. Intervistat janë realizuar në fillimin e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2018. Pas mbledhjes së të dhënave në terren, ato janë futur në bazën e të dhënave dhe pastaj janë përpunuar rezultatet, të cilat do të prezantohen në kuadër të këtij raporti.

Përzgjedhja e mostrës, hartimi i pyetësorëve dhe mbledhja e të dhënave është realizuar nga KEC. Në vijim do të prezantohen të gjeturat e këtij hulumtimi, të ndarë në disa kapituj dhe tema të ndryshme.

**ROMËT, ASHKALINJTË
DHE EGJIPTIANËT NË
SISTEMIN ARSIMOR**

5. Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët në sistemin arsimor

Arsimi është sektor tejet i rëndësishëm për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqëri, megjithatë, përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, mbetet ende në nivel jo të kënaqshëm dhe sfidë në të gjitha komunat. Kjo për arsye të kushteve socio-ekonomike të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, mungesës së interesimit nga ana e familjes dhe për faktin që arsimi ende nuk konsiderohet prioritet në shumicën e familjeve të këtyre komuniteteve. Niveli i ulët i arsimit, shkalla e ulët e aftësisë profesionale, shpijnë tutje në rrethin vicioz të pamundësisë së përfshirjes në tregun e punës dhe rritjes së varfërisë tek këto tri komunitete.

Ndonëse vërehet një rritje e pjesëmarrjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor në 17 vitet e fundit, në krahasim me mesataren e përgjithshme të Kosovës, kjo përqindje mbetet ende në nivel të ulët, veçanërisht në edukimin parashkollor dhe arsimin e mesëm të lartë.

Nxënësit rom, ashkali edhe egjiptian në vitin shkollor 2017/2018 përbëjnë 1.8% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në arsimin parauniversitar. Sipas Statistikave të Arsimit në Kosovë 2017/2018, 13 fëmijë rom, ashkali dhe egjiptian ndjekin nivelin parashkollor, dhe përbëjnë 0.2% të numrit të përgjithshëm të fëmijëve në nivelin parashkollor, ndërsa në nivelin parafillor janë të përfshirë 411 fëmijë rom, ashkali dhe egjiptian, përkatësisht 1.7% e numrit të përgjithshëm të fëmijëve në nivelin parafillor.










Pjesëmarrja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor (klasat 1-5) është më e mirë, mirëpo shkon duke u zvogëluar dukshëm në nivelet më të larta të arsimit. Në arsimin fillor janë 3,663 nxënës rom, ashkali dhe egjiptian apo 2.7% e numrit të përgjithshëm të nxënësve në nivelin fillor, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) janë 2,030 nxënës rom, ashkali dhe egjiptian, përkatësisht 1.8% e numrit të përgjithshëm të nxënësve në nivelin e mesëm të ulët. Arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12) e ndjekin 561 nxënës rom, ashkali dhe egjiptian dhe kjo përbën 0.6% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në nivelin e mesëm të lartë.

Numri i personelit arsimor nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar është gjithsej 14 mësimdhënës nga gjithsej 23,202 punonjës të arsimit në Kosovë.

Me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar, komunat në planet lokale të veprimit kanë paraparë masa dhe aktivitete të ndryshme si: lehtësimi i procedurave për regjistrim të fëmijëve në arsimin parauniversitar, rezervimi i vendeve (kuotave) për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore publike, përkrahja e nxënësve me veshmbathje dhe pako shkollore, ofrimi i bursave për nxënësit e shkollave të mesme të larta e të tjera. Megjithatë, nga të gjeturat










e hulumtimit mund të konstatohet se komunat nuk zbatojnë masat e lartpërmendura. Për më shumë hollësi rreth zbatimit të këtyre masave, shih tabelën në vijim.

Tabela 1. Zbatimi i masave për lehtësimin e regjistrimit dhe vijimit të arsimit të mesëm të lartë

	Komuna	 Rezervimi i vendeve (kuota) në institucionet parashkollore publike për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian	 Ofrimi i mbështetjes financiare për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian	 Lehtësim të procedurave për regjistrim
	Gjakovë	Po	Jo	Po
	Fushë Kosovë	Jo	Po	Jo
	Prizren	Jo	Jo	Jo
	Lipjan	Jo	Jo	Jo
	Gracanice	Jo	Po	Jo
	Ferizaj	Jo	Jo	Jo

Po ashtu, rezultatet e hulumtimit tregojnë se përkundër që masat tjera si mbështetja e nxënësve për blerjen e teksteve shkollore, shpërndarja e pakove shkollore, sigurimi i transportit falas për këto komunitete, që do të lehtësonin pengesat ekonomike, dhe potencialisht do të ndikojnë në rritjen e përfshirjes së nxënësve nga radhët e këtyre komuniteteve në arsim, realizohen shumë pak nga komunat e përfshira në këtë hulumtim. Për më shumë hollësi rreth kësaj, shih tabelën në vijim.

Tabela 2. Zbatimi i masave tjera për mbështetjen e shkollimit

				
Komuna		Komuna ofron mbështetje për blerjen e teksteve shkollore të nivelit të mesëm të lartë	Komuna ofron pako shkollore (çanta, fletore, lapsa, ngjyra, etj)	Komuna ofron transport për nxënësit të cilët banojnë larg objekteve shkollore
	Gjakovë	Jo	Jo	Po
	Fushë Kosovë	Po	Po	Jo
	Prizren	Jo	Jo	Jo
	Lipjan	Jo	Po	Po
	Graçanicë	Jo	Po	Jo
	Ferizaj	Jo	Jo	Po

5.1. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Ferizajt

Në Komunën e Ferizajt përfshirja e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar mbetet në nivel jo të kënaqshëm. Në këtë drejtim, në vitin shkollor 2017/2018 nuk ka pasur asnjë fëmijë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë në edukimin parashkollor. Ndërkaq, në arsimin parafillor ishin të përfshirë 63 fëmijë të komunitetit ashkali; në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët ishin të përfshirë 624 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; dhe 72 në arsimin e mesëm të lartë.⁴ Një faktor shumë i rëndësishëm i cili ndikon në këtë drejtim është edhe gjendja e rëndë socio-ekonomike e familjeve të këtyre komuniteteve.

⁴ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018.

Megjithatë, përveç nivelit jo të kënaqshëm të përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar, shqetësim tjetër është suksesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë, megjithëse për këtë nuk ka statistika të sakta zyrtare.⁵

Në këtë drejtim, me qëllim të avancimit të pozitës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit, Komuna e Ferizajt në planin lokal të veprimit ka paraparë si objektiv strategjik rritjen e përfshirjes dhe ofrimin e përkrahjes për të siguruar ambient shkollor miqësor për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Për arritjen e këtij objektiv është paraparë zbatimi i një numri të madh të aktiviteteve si, organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në arsimin parafillor dhe fillor, përcaktimi i kuotës për regjistrim në institucionet parashkollore publike, përkrahja e nxënësve me pako shkollore, organizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve për mësimdhënësit, organizimi i mësimit plotësues dhe të përsheptuar për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e të tjera.

Për të eksploruar sado pak zbatimin e aktiviteteve të lartcekura të parapara në planin lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Ferizajt, janë intervistuar drejtorë të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta si dhe përfaqësues të ZKKK të cilët janë pyetur për aspekte të ndryshme të cilat lidhen me realizimin e aktiviteteve.
















Në këtë drejtim, sa i përket organizimit të mësimit plotësues apo të përsheptuar për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, ekziston një mospërputhje ndërmjet informatave të ofruara nga drejtorët e shkollave dhe atyre të ofruara nga përfaqësuesit e ZKKK-së në komunën e Ferizajt. Të gjitha shkollat e përfshira në këtë hulumtim pohojnë se ofrojnë mësim plotësues apo të përsheptuar, megjithatë sipas ZKKK të kësaj komune, mësimi plotësues nuk ofrohet në shkolla. Po ashtu, përfaqësuesit e ZKKK-së deklarojnë se për nxënësit të cilët banojnë larg objekteve shkollore, komuna siguron transport falas, mirëpo e njëjta nuk konfirmohet nga drejtorët e shkollave të përfshirë në këtë hulumtim. Për më shumë, komuna nuk shpërndan pako shkollore dhe nuk ofron mbështetje për blerjen e teksteve shkollore për nivelin e mesëm të lartë.

Komuna e Ferizajt nuk ofron programe për arsimimin e të rriturve, që kanë për qëllim përfshirjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në programet e përsheptuara për përfundimin e shkollimit fillor dhe të mesëm, mirëpo ka mbështetur pesë studentë rom, ashkali dhe egjiptian përmes bursave që të ndjekin studimet universitare.

Sa i përket trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve, në komunën e Ferizajt shumica e mësimdhënësve, në të gjitha nivelet e arsimit, kanë ndjekur trajnime që ndërlidhen me mësimdhënien në klasë diverse, kuptimin e kulturave të ndryshme dhe me qasjen ndaj nxënësve të komuniteteve rom, egjiptian dhe ashkali. Për më shumë hollësi rreth trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit e Komunës së Ferizajt, shih tabelën në vijim.

5 Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Ferizajt, http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1416/plv_per_komunitete_-_ferizaj_-_alb.pdf

Tabela 3. Trajnimet e ndjekura nga mësimdhënësit në Komunën e Ferizajt

	 Trajnimet për mësimdhënie në një klasë diverse		 Trajnimet që ndërlidhen me kuptimin e kulturave të ndryshme		 Trajnimet që ndërlidhen me qasjen ndaj nxënësve rom, ashkali, egjiptian	
	%	NUMRI	%	NUMRI	%	NUMRI
Po	65.7% 	23	77.1% 	27	80% 	28
Jo	22.9% 	8	11.4% 	4	8.6% 	3
Gjithsej	88.6% 	31	88.6% 	31	88.6% 	31
Ref/PP	11.4% 	0	11.4% 	0	11.4% 	0

Megjithatë, përkundër trajnimeve të ndjekura për diversitetin dhe të kuptuarit e kulturave të ndryshme si dhe organizimit të aktiviteteve të shumta kulturore, 31% e mësimdhënësve të Komunës së Ferizajt të përfshirë në këtë hulumtim pohojnë se në shkollë nuk diskutohet asnjëherë për historinë dhe kulturën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Shumica dërmuese e mësimdhënësve deklarojnë se në shkollë nuk ka diskriminim në mes të nxënësve dhe e njëjta konfirmohet edhe nga përfaqësuesit e ZKKK-së.

Integrimi i nxënësve të komuniteteve në klasë është tejet i rëndësishëm në suksesin e tyre të përgjithshëm në arsim. Megjithatë, përveç nivelit jo të kënaqshëm të përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelet e edukimit parashkollor, arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të lartë, një shqetësim tjetër konsiderohet të jetë suksesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë. Në këtë drejtim, shumica dërmuese, 97% e mësimdhënësve pajtohen që nxënësit e këtyre komuniteteve marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e organizuara nga shkolla, megjithatë, performanca e tyre është jo e kënaqshme krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë, ku pjesa më e madhe e mësimdhënësve (46%) janë shprehur se ata kanë nota kaluese. Për më shumë lidhur me përgjigjet e mësimdhënësve mbi suksesin e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian, shih tabelën në vijim.

Tabela 4. Performanca e përgjithshme e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian



Cila është performanca e përgjithshme e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në krahasim me klasën?

	NUMRI	%	
Jo kaluese	1	2.9	
Kaluese	16	45.7	
Mirë	13	37.1	
Shumë mirë	5	14.3	
Gjithsej	35	100.0	

Përdorimi i metodave të ndryshme të punës si dhe organizimi i aktiviteteve të ndryshme e bën më tërheqës dhe të dobishëm procesin edukativo-arsimor për fëmijët. Në këtë drejtim, bazuar në përgjigjet e ofruara nga mësimdhënësit e shkollave të Komunës së Ferizajt të cilët punojnë me fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me metodat e punës të cilat i zbatojnë në klasë, mund të konstatohet se gjatë procesit edukativo-arsimor përdoren metoda të ndryshme të punës dhe organizohen aktivitete të ndryshme. Më shumë lidhur me metodat e punës gjatë procesit edukativo-arsimor të mësimdhënësve të Komunës së Ferizajt, shih tabelën përmbledhëse në vijim.

Tabela 5. Metodatat e punës së mësimdhënësve në Komunën e Ferizajt

Sa shpesh përdoren metodatat e mëposhtme të punës?	Më pak se një herë në muaj		Të paktën një herë në muaj		Të paktën një herë në javë		Të paktën një herë gjatë orës mësimore		Ref/PP		Gjithsej	
	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%
Sa shpesh mësojnë nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian përmes teknologjisë në klasë (video, internet, kompjuter)?	2	5.7	4	11.4	18	51.4	3	8.6	8	22.9	35	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë punë eksperimentale ose praktike?			7	20	14	40	1	2.9	13	37.1	35	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian lexojnë në qetësi?							28	80	7	20	35	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian lexojnë me zë?	1	2.9					25	71.4	9	25.7	35	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian shkruajnë hartime dhe raporte në bazë të hulumtimeve?	6	17.1	12	34.3	3	8.6	1	2.9	13	37.1	35	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian prezantojnë para klasës?	2	5.7	14	40	13	37.1	2	5.7	4	11.4	35	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian punojnë në projekte të pavarura dhe afatgjata?	16	45.7	3	8.6			2	5.7	14	40	35	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian debatojnë për idetë e tyre ose i shpjegojnë ato në forma të tjera?					4	11.4	24	68.6	7	20	35	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian përdorin punëdore ose modele për zgjidhjen e problemeve.			3	8.6	6	17.1	5	14.3	21	60	35	100

Fenomeni i braktisjes së shkollimit vazhdon të mbetet prezent tek nxënësit nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Faktor të ndryshëm ndikojnë në braktisjen e shkollimit dhe suksesin jo të mirë të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian, përfshirë, gjendja e rëndë socio-ekonomike e familjeve të këtyre komuniteteve, të cilët shumë shpesh nuk kanë mundësi që të sigurojnë veshmbathjet apo materialet e nevojshme shkollore. Po ashtu, faktor tjetër i cili ndikon në këtë drejtim është edhe interesimi i pamjaftueshëm i prindërve për arsimimin e fëmijëve të tyre. E njëjta është konfirmuar edhe nga intervistat me mësimdhënësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë hulumtim, shumica e të cilëve kanë pohuar se krahasuar me prindërit tjerë, prindërit e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian nuk marrin pjesë në mbledhjet me prindër.

Tabela 6. Pjesëmarrja e prindërve të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në mbledhjet me prindër



Në krahasim me prindërit tjerë, prindërit e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian nuk janë prezent në mbledhjet me prindër

	NUMRI	%	
Pajtohem plotësisht	8	22.9	
Pajtohem pjesërisht	3	8.6	
Nuk kam mendim	8	22.9	
Nuk pajtohem pjesërisht	5	14.3	
Nuk pajtohem aspak	11	31.4	
Gjithsej	35	100.0	

Në këtë drejtim, vetëdija e ulët e prindërve për shkollim është përmendur si arsye kryesore e braktisjes, duke pasuar nga gjendja socio-ekonomike, martesat e hershme dhe mos-interesimi i vet nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për shkollim. Gjatë vitit shkollor 2017/2018, 7 nxënës ashkali kanë braktisur shkollimin në shkollat pjesëmarrëse në këtë hulumtim, 3 prej të cilëve janë vajza.

Nga pesë drejtorët e shkollave të intervistuar, të gjithë janë deklaruar se shkollat e tyre kanë organizuar fushata vetëdijësuese me prindër të nxënësve të këtyre komuniteteve për promovimin e rëndësisë së arsimit. Gjithashtu, ZKKK e Ferizaj ka realizuar 3-4 fushata vetëdijësuese për braktisjen dhe riatdhesimin, për promovimin e rëndësisë së arsimit dhe promovimin e edukimit parashkollor.

Për më shumë, me qëllim të parandalimit të braktisjes janë themeluar Ekipet për Reagim ndaj Regjistrimit dhe Parandalimit të Braktisjes në nivel lokal dhe në nivel të shkollës. Komuna e Ferizajt nuk ka plan të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë, por e ka funksionale dhe të trajnuar EPRMB. Nga

pesë drejtorët e intervistuar të shkollave të Ferizajt, katër prej tyre kanë pohuar se shkollat e tyre kanë hartuar plane të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit në shkollë dhe gjithashtu katër prej tyre i kanë funksionalizuar EPRMB-të. Tre nga këto shkolla janë të njoftuara nga MASHT rreth instrumenteve për parandalim të hershëm të braktisjes.

Buxheti komunal për realizimin e aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar nuk është ofruar nga përfaqësuesit e ZKKK-së, të cilët kanë deklaruar që burim i financimit është buxheti komunal dhe se investimet kryesore në kuadër të këtij buxheti ndahen për shëndetësi, fatkeqësi natyrore dhe në infrastrukturë.

5.2. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës

Ngjashëm sikur në gjithë Kosovën, edhe në Komunën e Fushë Kosovës përfshirja e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar mbetet në nivel jo të kënaqshëm, krahasuar me përfshirjen e fëmijëve nga komuniteti shumicë. Në komunën e Fushë Kosovës në vitin shkollor 2017/2018 në edukimin parashkollor dhe arsimin parafillor nuk ka qenë i përfshirë asnjë fëmijë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Ndërkaq, në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët ishin të përfshirë 529 nxënës rom dhe ashkali dhe vetëm 60 ishin të përfshirë në arsimin e mesëm të lartë.⁶ Faktorë të rëndësishëm të cilët ndikojnë në këtë drejtim janë gjendja jo e mirë socio-ekonomike me të cilën ballafaqohen këto tri komunitete si dhe vetëdijësimi i ulët i prindërve për rëndësinë e arsimimit. Një shqetësim tjetër që ndërlihet me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është edhe suksesi i dobët i tyre në arsimin parauniversitar.

Me qëllim të adresimit të sfidave të lartpërmendura në fushën e arsimit, Komuna e Fushë Kosovës në planin lokal të veprimit ka përcaktuar si objektiv strategjik – Rritjen e përfshirjes dhe bashkëpunimit me prindër për ngritjen e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin para-universitar në Komunën e Fushë-Kosovës.⁷ Si i tillë objektiv strategjik përbëhet nga një numër i aktiviteteve si: hartimi i planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mos-regjistrimit, masa stimuluese për regjistrimin e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë, mbështetja e programeve për arsimimin e të rriturve, ofrimi i mësimi plotësues, organizimi i aktiviteteve vetëdijësuese për rëndësinë e shkollimit, promovimi i vlerave, trashëgimisë dhe identitetit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.⁸

Në këtë drejtim, për të kuptuar më mirë se cilat nga aktivitetet e mësipërme të parapara në planin lokal të veprimit të Komunës së Fushë Kosovës realizohen nga komuna, të gjeturat nga intervistat e realizuara me përfaqësues të ZKKK dhe drejtorë të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta tregojnë se disa nga masat që i ndërmerr Komuna për rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar janë: masat stimuluese për lehtësimin e regjistrimit dhe vijimit të nxënësve të këtyre komuniteteve në arsimin e mesëm të lartë, ofrimi i mbështetjes financiare, mbështetjes për blerjen e teksteve

6 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018.

7 Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës, http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1430/plv_per_komunitete_-_fushë_kosove_-_alb.pdf

8 Po aty.










shkollore për nxënësit e nivelit të mesëm të lartë, sigurimi i transportit falas për nxënësit që banojnë larg objekteve shkollore, si dhe ofrimi i pakove shkollore.

Për më shumë, me qëllim të lehtësimit të regjistrimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në institucionet parashkollore, komuna ndërmerr masa si rezervimi i vendeve në institucione parashkollore për fëmijë të këtyre komuniteteve, kurse për nxënësit që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë, komuna deklaron se ofron bursa. Megjithatë, Komuna e Fushë Kosovës nuk ndërmerr masa për identifikimin e nxënësve të këtyre tre komuniteteve për regjistrim në arsimin parauniversitar. Po ashtu, sa i përket arsimimit të të rriturve, në Komunën e Fushë Kosovës nuk ofrohen programe të përsheptuara për përfundimin e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.

Vetëm në dy shkollat e intervistuar organizohet mësimi plotësues apo përsheptues për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian. Gjithashtu, vetëm në një nga shkollat ofrohet përgatitje intensive, kurse ose orë plotësuese për testin e arritshmërisë dhe maturës për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian.

Një aktivitet tjetër i cili parashihet të realizohet në kuadër të PLV për përfshirje të komuniteteve në Komunën e Fushë Kosovës është edhe eliminimi i diskriminimit ndaj fëmijëve të këtyre komuniteteve, përmes organizimit të trajnimeve me mësimdhënës për gjithëpërfshirje si dhe organizimit të aktiviteteve jashtëmësimore me përfshirje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në këtë drejtim, nga intervistat me mësimdhënës vërehet se shumica dërmuese e mësimdhënësve, 9 nga 10 të intervistuar në këtë komunë nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim për gjithëpërfshirje, ndërkaq vetëm një (1) mësimdhënës ka marrë pjesë në trajnime që ndërlidhen me mësimdhënie në klasë diverse, qasje ndaj nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian, dhe për kuptimin e kulturave të ndryshme. Për më shumë lidhur me pjesëmarrjen e mësimdhënësve të Komunës së Fushë Kosovës në trajnime për gjithëpërfshirje, shih tabelën në vijim.

Tabela 7. Trajnimet e ndjekura nga mësimdhënësit në Komunën e Fushë Kosovës

	Temat e trajnimeve ndërlidhen me mësimdhënie në një klasë diverse.		Temat e trajnimeve ndërlidhen me kuptimin e kulturave të ndryshme.		Temat e trajnimeve ndërlidhen me qasjen ndaj nxënësve rom, ashkali, egjiptian.	
	%	NUMRI	%	NUMRI	%	NUMRI
Po	10% 	1	10% 	1	10% 	1
Jo	90% 	9	90% 	9	90% 	9
Gjithsej	100% 	10	100% 	10	100% 	10

Për më shumë, sa i përket organizimit të aktiviteteve që ndërlidhen me diversitetin, shtatë (7) prej shkollave pjesëmarrëse në këtë hulumtim deklarojnë se nuk kanë realizuar asnjë aktivitet që ndërlidhet me diversitetin dhe kulturën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ngjashëm, nëntë (9) mësimitdhënës të Komunitetit të Fushë Kosovës të përfshirë në këtë hulumtim pohojnë se në klasë asnjëherë nuk flitet për historinë dhe kulturën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Përderisa nëntë (9) mësimitdhënës kanë deklaruar se nuk mendojnë që ka diskriminim në mes të nxënësve në shkollë, vetëm një mësimitdhënës ka deklaruar ndryshe.

Një shqetësim tjetër që ndërlidhet me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është edhe suksesi i dobët i tyre në arsimin parauniversitar. Në këtë drejtim, mësimitdhënës të përfshirë në këtë hulumtim tregojnë se nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në përgjithësi kanë performancë kaluese dhe të mirë, e që është jo e kënaqshme krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë.

Tabela 8. Performanca e përgjithshme e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian



Cila është performanca e përgjithshme e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në krahasim me klasën?

	NUMRI	%	
Kaluese	4	40.0	<div style="width: 40%;"></div>
Mirë	5	50.0	<div style="width: 50%;"></div>
Shumë mirë	1	10.0	<div style="width: 10%;"></div>
Gjithsej	10	100.0	<div style="width: 100%;"></div>

Duke marrë parasysh që përdorimi i metodave të ndryshme të punës si dhe organizimi i aktiviteteve të ndryshme e bën më të dobishëm procesin edukativo-arsimor, mësimitdhënës të Komunitetit të Fushë Kosovës të cilët punojnë me fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë pyetur lidhur me metodat e punës të cilat i zbatojnë në klasë. Në këtë drejtim, nga përgjigjet e mësimitdhënësve mund të konstatohet se ata përdorin metoda të ndryshme të punës, shfrytëzojnë teknologjinë dhe organizojnë aktivitete të ndryshme. Për më shumë, shumica e mësimitdhënësve kanë pohuar se nxënës bëjnë punë eksperimentale ose lexojnë në qetësi të paktën një herë në javë. Për më shumë hollësi rreth metodave të punës së mësimitdhënësve, shih tabelën në vijim.

Tabela 9. Metodatat e punës së mësimdhënësve në Komunën e Fushë Kosovës

Sa shpesh përdoren metodatat e mëposhtme të punës?	Asnjëherë		Më pak se një herë në muaj		Të paktën një herë në muaj		Të paktën një herë në javë		Të paktën një herë gjatë orës mësimore		Gjithsej	
	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%
Sa shpesh mësojnë nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian përmes teknologjisë në klasë (video, internet, kompjuter)?	0	0	1	10	2	20	6	60	1	10	10	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë punë eksperimentale ose praktike?	0	0	1	10	3	20	4	40			10	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian lexojnë në qetësi?	0	0	3	30	1	10	4	40	2	20	10	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian lexojnë me zë?	0	0	3	30	3	30	2	20	2	20	10	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian shkruajnë hartime dhe raporte në bazë të hulumtimeve?	1	10	4	40	2	20	2	20	1	10	10	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë prezentime para klasës?	0	0	3	30	4	40	3	30	0	0	10	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian punojnë në projekte të pavarura dhe afatgjata?	1	10	7	70	2	20	0	0	0	0	10	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian debatojnë për idetë e tyre ose i shpjegojnë ato në forma të tjera?	0	0	1	10	3	30	3	30	3	30	10	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian përdorin punëdore ose modele për zgjidhjen e problemeve.	2	20	4	40	1	10	2	20	1	10	10	100

Braktisja e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar në Komunën e Fushës-Kosovës, e në veçanti në nivelin e shkollimit të detyrueshëm (fillor dhe të mesëm të ulët) përbën një nga sfidat e fushës së arsimit me të cilat përballet Komuna. Shkaqet kryesore të braktisjes së shkollimit nga nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian janë gjendja ekonomike dhe vetëdija e ulët e prindërve të këtyre nxënësve për shkollim. Për këtë qëllim, PLV për komunitete në Komunën e Fushë Kosovës ka paraparë hartimin e planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit.

Në këtë drejtim, të gjeturat nga hulumtimi tregojnë se Komuna e Fushë-Kosovës ka themeluar Ekipet për Parandalim dhe Reagim Ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM) në nivel shkolle dhe në nivel komunal. Disa nga masat e ndërmarra nga EPRBM janë takimet me prindër, si dhe bashkëpunimi me organizata jo-qeveritare dhe komunën. Po ashtu, drejtorët e shkollave pjesëmarrëse në këtë hulumtim kanë deklaruar se gjatë këtij viti, shkollat kanë organizuar fushata vetëdijësuese me prindër të nxënësve rom, egjiptian dhe ashkali për promovimin e rëndësisë së arsimit, të cilat do të vazhdojnë edhe vitin e ardhshëm.

Buxheti komunal i Komunës së Fushë Kosovës për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është 3,000 EUR, kurse burim i financimit është buxheti komunal. Investimet kryesore nga ky buxhet janë në subvencionet për pjesëtarët e këtyre komuniteteve.

5.3. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Graçanicës

Komuna e Graçanicës përballet me nivel shumë të ulët të pjesëmarrjes së fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parashkollor dhe arsimin parafillor në institucionet arsimore të kësaj komune, përfshirë shkollat serbe.

Një nga problemet me të cilat përballen fëmijët dhe familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është fakti se fëmijët vijojnë shkollimin edhe në shkollat serbe, të cilat funksionojnë me sistem paralel nga Serbia dhe rrjedhimisht janë në shpërputhje me sistemin arsimor të Kosovës. Më tutje, këta nxënës kanë vështirësi në regjistrim në shkollimin e mesëm të lartë ose në universitete në gjuhën shqipe, qoftë për shkak të mosnjohjes së gjuhës shqipe, qoftë për shkak të mospërputhjes së sistemit të arsimit. Megjithatë, përkundër pjesëmarrjes së ulët të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar, shqetësim tjetër mbetet suksesi jo i mirë i nxënësve në mësim, mos regjistrimi në kohë në klasë të parë, niveli i lartë i braktisjes së shkollimit, sidomos në nivelet më të larta të arsimit, gjendja e vështirë socio-ekonomike e të tjera.⁹

Duke e pasur parasysh gjendjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit, Komuna e Graçanicës në planin lokal të veprimit ka paraparë zbatimin e disa aktiviteteve që synojnë të rrisin pjesëmarrjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar, në veçanti në edukimin parashkollor dhe arsimin e mesëm të lartë. Për këtë qëllim janë paraparë aktivitete të ndryshme si: vetëdijësimi i prindërve për rëndësinë e shkollimit, identifikimi i fëmijëve për regjistrim, sigurimi i teksteve shkollore, sigurimi i transportit, parandalimi i braktisjeve të shkollimit, organizimi i aktiviteteve jashtëmësimore, ndarja e bursave për nxënësit e përfshirë në arsimin e mesëm të lartë dhe arsimin e lartë e të tjera.¹⁰

9 Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Graçanicës, http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1427/plv_per_komunitete_-_gracanica_-_alb.pdf

10 Po aty.










Për të kuptuar sado pak zbatimin e aktiviteteve të lartcekura, të parapara në planin lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Graçanicës, janë realizuar intervista me përfaqësues të ZKKK-së dhe drejtorë të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta. Në këtë drejtim, sa i përket masave lehtësuese për vijimin e arsimit, të gjeturat nga intervistat e realizuara tregojnë se Komuna e Graçanicës nuk siguron transport falas për nxënësit të cilët jetojnë larg objekteve shkollore, nuk ofron mbështetje për blerjen e teksteve shkollore për nxënësit e përfshirë në nivelin e mesëm të lartë, por ofron pako shkollore për nxënësit e këtyre komuniteteve. Po ashtu, komuna ofron bursa për mbështetjen e studentëve nga radhët e këtyre komuniteteve që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë.

Në anën tjetër, komuna nuk ofron programe për arsimimin e të rriturve që kanë për qëllim përfshirjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në programet intensive për përfundimin e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.

Sa i përket trajnimeve kundër diskriminimit si dhe organizimit të aktiviteteve që lidhen me diversitetin, në shkollat e Komunës së Graçanicës organizohen aktivitete që lidhen me diversitetin dhe kulturën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ndonëse, këto aktivitete organizohen për diversitetin dhe të kuptuarit e kulturave të ndryshme, vetëm në dy (2) nga shkollat pjesëmarrëse në këtë hulumtim është shënuar dita rome, ndërkaq në të tjerat janë organizuar aktivitete kulturore sportive dhe gara të ndryshme.

Për më shumë, shumica e mësimitdhënësve, në të gjitha nivelet e arsimit kanë ndjekur trajnime që ndërlidhen me mësimitdhënien në klasë diverse, kuptimin e kulturave të ndryshme si dhe me qasjen ndaj nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Për më shumë hollësi rreth trajnimeve të ndjekura nga mësimitdhënësit e Komunës së Graçanicës, shih tabelën në vijim.

Tabela 10. Trajnime e ndjekura nga mësimitdhënësit për gjithëpërfshirje në Komunën e Graçanicës.

	Trajnime që ndërlidhen me mësimitdhënie në një klasë diverse		Trajnime që ndërlidhen me kuptimin e kulturave të ndryshme		Trajnime që ndërlidhen me qasjen ndaj nxënësve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian	
	%	NUMRI	%	NUMRI	%	NUMRI
Po	86% 	12	50% 	7	86% 	12
Jo	0%	0	50% 	7	0%	0
Ref/PP	14% 	2	0%	0	14% 	2
Gjithsej	100% 	14	100% 	14	100% 	14

Në përgjithësi, mësime të ndryshme dhe drejtorët e shkollave pajtohen se nuk ka diskriminim në mes të nxënësve dhe se nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e shkollës, dhe janë aktiv gjatë orëve mësimore.

Për dallim nga komunat tjera, në komunën e Graçanicës vlerësohet se nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian kanë performancë të përgjithshme më të mirë, ku shumica (43%) e mësime të ndryshme kanë deklaruar se nxënësit nga këto komunitete kanë sukses të mirë dhe shumë të mirë. Për më shumë hollësi shih tabelën në vijim.

Tabela 11. Performanca e përgjithshme e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Graçanicës.



Cila është performanca e përgjithshme e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në krahasim me klasën?

	NUMRI	%	
Kaluese	4	28.6%	<div style="width: 28.6%;"></div>
Mirë	6	42.9%	<div style="width: 42.9%;"></div>
Shumë mirë	4	28.6%	<div style="width: 28.6%;"></div>
Gjithsej	14	100%	<div style="width: 100%;"></div>

Sa i përket përdorimit të metodave të ndryshme të punës si dhe organizimit të aktiviteteve të ndryshme, mësime të ndryshme të Komunës së Graçanicës shprehin se përdorin metoda të ndryshme të mësime të ndryshme. Për më shumë hollësi lidhur me metodat e punës gjatë procesit edukativo-arsimor të mësime të ndryshme, shih tabelën në vijim.

Tabela 12. Metodatat e punës së mësimdhënësve në Komunën e Graçanicës

Sa shpesh përdoren metodatat e mëposhtme të punës?	Asnjëherë		Më pak se një herë në muaj		Të paktën një herë në muaj		Të paktën një herë në javë		Të paktën një herë gjatë orës mësimore		Ref/PP		Gjithsej	
	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%
Sa shpesh mësojnë nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian përmes teknologjisë në klasë (video, internet, kompjuter)?	0	0	4	28.6	0	0	2	14.3	8	57.1	0	0	14	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë punë eksperimentale ose praktike?	0	0	2	14.3	2	14.3	6	42.9	4	28.6	0	0	14	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian lexojnë në qetësi?	0	0	4	28.6	3	21.4	3	21.4	4	28.6	0	0	14	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian lexojnë me zë?	2	14.3	6	42.9	1	7.1	3	21.4	2	14.3	0	0	14	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian shkruajnë hartime dhe raporte në bazë të hulumtimeve?	0	0	5	35.7	3	21.4	3	21.4	2	14.3	1	7.1	14	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë prezentime para klasës?	0	0	2	14.3	4	28.6	6	42.9	2	14.3	0	0	14	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian punojnë në projekte të pavarura dhe afatgjata?	1	7.1	7	50	4	28.6	1	7.1	1	7.1	0	0	14	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian debatojnë për idetë e tyre ose i shpjegojnë ato në forma të tjera?	0	0	1	7.1	4	28.6	5	35.7	4	28.6	0	0	14	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian përdorin punëdore ose modele për zgjidhjen e problemeve.	0	0	6	42.9	2	14.3	2	14.3	4	28.6	0	0	14	100

Fenomeni i braktisjes së shkollimit vazhdon të jetë prezent tek nxënësit nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Shkaqet kryesore të braktisjes së shkollimit nga nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian janë gjendja ekonomike, dhe mos vetëdijësimi i prindërve të këtyre nxënësve për rëndësinë e shkollimit. Për këtë qëllim, PLV për komunitete në Komunën e Graçanicës ka paraparë si aktivitet identifikimin dhe adresimin e rasteve të braktisjes së shkollimit nga nxënësit, me ç'rast ekipi për parandalim dhe reagim ndaj mosregjistrimit (EPRMB) në nivel komunal do të ndërmerr masat e nevojshme për rikthimin e tyre në procesin edukativo-mësimor. Po ashtu, me qëllim të parandalimit të braktisjes së shkollimit, Komuna ka planifikuar që të organizojë 3-4 fushata vetëdijësuese me prindër lidhur me rëndësinë e shkollimit. Për më shumë në këtë drejtim vlen të theksohet se asnjë nga shkollat e Komunës së Graçanicës nuk kanë të themeluar EPRMB-të.

Sa i përket organizimit të mësimin plotësues apo të përsheptuar për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, në shkollat e Komunës së Graçanicës ofrohet mësimi plotësues në lëndën e gjuhës dhe matematikës dhe gjithashtu në lëndë të tjera sipas nevojës. Për më shumë, mësimet plotësuese organizohen nga mësimdhënësit e shkollës. Në 80% të rasteve orët plotësuese organizohen 2-3 herë në javë, kurse në 20% të rasteve 3-4 herë në javë. Nga shkollat pjesëmarrëse në këtë hulumtim, vetëm tre drejtorë kanë pohuar së ofrojnë përgatitje intensive, kurse, ose orë plotësuese për testin e arritshmërisë dhe maturës për nxënësit e këtyre tri komuniteteve.

Komuna ka të ndarë një buxhet prej 15,000 EUR nga buxheti komunal për aktivitetet me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të cilat shpenzohen në subvencione, shkollim dhe rini dhe sport.

5.4. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Gjakovës

Në Komunën e Gjakovës përfshirja e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar mbetet në nivel jo të kënaqshëm. Gjatë vitit shkollor 2017/2018 në edukimin parashkollor ka qenë i përfshirë vetëm një (1) fëmijë nga komuniteti rom, ndërkaq në edukimin parafillor ishin të përfshirë 95 fëmijë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët ishin të përfshirë 1,324 nxënës të këtyre komuniteteve, ndërsa, në arsimin e mesëm të lartë ishin të përfshirë 130 nxënës, e që përbën një numër shumë të vogël krahasuar me numrin e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët.¹¹ Përkundër që mungojnë të dhëna të sakta për numrin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në Komunën e Gjakovës, nga të dhënat e mësipërme mund të konstatohet se niveli i përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin e detyruar është i kënaqshëm, ndërsa përfshirja e tyre në edukimin parashkollor, klasën parafillore dhe shkollimin e mesëm të lartë është shumë i ulët.

Megjithatë, përveç nivelit jo të kënaqshëm të përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar në Komunën e Gjakovës, shqetësim tjetër konsiderohet edhe suksesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë.¹² Një sfidë tjetër me të cilën përballen komunitetet rom,

11 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018.

12 Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës, http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1418/plv_per_komunitete_-_gjakove_-_alb.pdf

ashkali dhe egjiptian është edhe gjendja e vështirë socio-ekonomike e cila ndikon në përfshirjen e tyre në arsim, dhe rrjedhimisht braktisjen e shkollimit.

Në këtë drejtim, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme të arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, Komuna e Gjakovës në planin e saj të veprimit ka paraparë si objektiv strategjik rritjen e përfshirjes dhe ngritjen e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Si i tillë, objektiv i strategjik parasheh zbatimin e një numri të madh të aktiviteteve si: fushata informuese dhe ofrimi i ndihmës për regjistrimin e fëmijëve në shkolla, përcaktimi i kuotës për regjistrim në institucionet parashkollore publike, përkrahja e nxënësve me pako shkollore, ofrimi i bursave për nxënësit e përfshirë në arsimin e mesëm të lartë, organizimi i mësimit plotësues në shkolla e të tjera.¹³

Në këtë drejtim, për të kuptuar më mirë se cilat nga aktivitetet e mësipërme të parapara në planin lokal të veprimit të Komunës së Gjakovës realizohen nga komuna, të gjeturat nga intervistat e realizuara me përfaqësues të ZKKK-së dhe drejtorë të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta tregojnë se disa nga masat që i ndërmerret Komuna për rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar janë: masa lehtësuese për regjistrimin e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e detyrueshëm, përcakton kuota për regjistrimin e fëmijëve në edukimin parashkollor dhe parafillor. Megjithatë, nga aktivitetet e lartpërmendura të parapara në PLV, Komuna nuk ofron mbështetje financiare as mbështetje në blerjen e teksteve shkollore, nuk përkrah nxënësit me pako shkollore, dhe nuk ofron bursa për nxënësit e përfshirë në arsimin e mesëm të lartë. Në anën tjetër Komuna siguron transport falas për nxënësit të cilët banojnë larg objekteve shkollore.

Sa i përket organizimit të fushatave vetëdijësuese për rëndësinë e arsimit, përfaqësues të ZKKK-së kanë deklaruar se Komuna nuk ka organizuar asnjë fushatë vetëdijësuese për promovimin e rëndësisë së arsimit, në veçanti rëndësisë së edukimit parashkollor. Për më shumë, përkundër që organizimi i fushatave vetëdijësuese është paraparë si aktivitet në planin lokal të veprimit, Komuna nuk ka planifikuar aktivitete të tilla as për vitin e ardhshëm.

Vlen të theksohet se në shkollat e Komunës së Gjakovës ka të punësuar mësime të mësimdhënës nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por ngjashëm si në komunat tjera, as në Komunën e Gjakovës nuk ofrohet lënda e gjuhës rome. Po ashtu, lidhur me organizimin e mësimit plotësues, në Komunën e Gjakovës ofrohet mësimi plotësues për lëndën e gjuhës shqipe dhe matematikës, shkrim lexim dhe lëndë të tjera sipas nevojës.

Sa i përket trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve, në Komunën e Gjakovës shumica e mësime të mësimdhënësve, në të gjitha nivelet e arsimit kanë ndjekur trajnime që ndërlidhen me mësime të mësimdhënien në klasë diverse, kuptimin e kulturave të ndryshme dhe me qasjen ndaj nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Për më shumë hollësi rreth trajnimeve të ndjekura nga mësime të mësimdhënësve të Komunës së Gjakovës, shih tabelën në vijim.

13 Po aty.

Tabela 13. Trajnimet e ndjekura nga mësime ndërkulturore në Komunën e Gjakovës

	Trajnime që ndërlidhen me mësime ndërkulturore në një klasë diverse		Trajnime që ndërlidhen me kuptimin e kulturave të ndryshme		Trajnime që ndërlidhen me qasjen ndaj nxënësve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian	
	%	NUMRI	%	NUMRI	%	NUMRI
Po	59%	24	63%	26	54%	22
Jo	24.4%	10	20%	8	29%	12
Pa përgjegje	17%	7	17%	7	17%	7
Gjithsej	100%	41	100%	41	100%	41

Në këtë drejtim, në shkollat e Komunës së Gjakovës po ashtu organizohen aktivitete të ndërlidhura me diversitetin dhe kulturën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Megjithatë, shumica e mësime ndërkulturore të cilët kanë marrë pjesë në këtë hulumtim deklarojnë se gjatë orëve mësimore nuk flitet për historinë dhe kulturën e këtyre tri komuniteteve.

Integrimi i nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në klasë është tejet i rëndësishëm në suksesin e tyre të përgjithshëm në arsim. Në këtë drejtim, të pyetur për suksesin e përgjithshëm të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, pjesa më e madhe e mësime ndërkulturore të intervistuar shprehen se ata kanë sukses të mirë, e që është më i ulët se suksesi i përgjithshëm i komunitetit shumicë.

Tabela 14. Performanca e përgjithshme e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Gjakovës

	NUMRI	%
Kaluese	15	36.6
Mirë	22	53.7
Shumë mirë	3	7.3
Shkëlqyeshëm	1	2.4
Gjithsej	41	100.0

Duke marrë parasysh rëndësinë e metodave të ndryshme të punës dhe organizimit të aktiviteteve të ndryshme gjatë procesit edukativo-arsimor në mësim nxënës, mësime ndërkulturore të shkollave të Komunës së Gjakovës të cilët punojnë me fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian shprehen se përdorin metoda të ndryshme, prej të cilave më së shumti praktikohet leximi me zë. Për më shumë hollësi rreth metodave të punës, shih tabelën e përmbledhur si në vijim.

Tabela 15. Metodatat e punës së mësimdhënësve në Komunën e Gjakovës

Sa shpesh përdoren metodatat e mëposhtme të punës?	Asnjëherë		Më pak se një herë në muaj		Të paktën një herë në muaj		Të paktën një herë në javë		Të paktën një herë gjatë orës mësimore		Gjithsej	
	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%
Sa shpesh mësojnë nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian përmes teknologjisë në klasë (video, internet, kompjuter)?	8	19.5	7	17.1	10	24.4	11	26.8	5	12.2	41	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë punë eksperimentale ose praktike?	2	4.9	3	7.3	12	29.3	13	31.7	11	26.8	41	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian lexojnë në qetësi?	17	41.5	4	9.8	2	4.9	11	26.8	7	17.1	41	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian lexojnë me zë?	12	29.3	3	7.3	1	2.4	7	17.1	18	43.9	41	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian shkruajnë hartime dhe raporte në bazë të hulumtimeve?	5	12.2	9	22	15	36.6	11	26.8	1	2.4	41	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë prezentime para klasës?	3	7.3	6	14.6	5	12.2	13	31.7	14	34.1	41	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian punojnë në projekte të pavarura dhe afatgjata?	6	14.6	18	43.9	9	22	7	17.1	1	2.4	41	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian debatojnë për idetë e tyre ose i shpjegojnë ato në forma të tjera?	1	2.4	4	9.8	5	12.2	12	29.3	19	46.3	41	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian përdorin punëdore ose modele për zgjidhjen e problemeve.	6	14.6	4	9.8	11	26.8	10	24.4	10	24.4	41	100

Fenomeni i braktisjes së shkollimit vazhdon të jetë prezent tek nxënësit nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në përgjithësi, 17 nxënës rom (8 prej tyre vajza) dhe 34 ashkali (13 prej tyre vajza), e kanë braktisur shkollimin në këto shkollat e intervistuar të Komunës së Gjakovës. Arsyet e braktisjes së shkollimit janë gjendja e vështirë socio-ekonomike, vetëdija e ulët e prindërve për rëndësinë e shkollimit, martesat e hershme dhe emigrimi. Për këtë qëllim, Komuna ka hartuar planin për parandalim të braktisjes dhe mosregjistrimit si dhe ka themeluar EPRMB në nivel komunal dhe në nivel të shkollës. Nga 12 shkollat pjesëmarrëse në këtë hulumtim, 10 prej tyre e kanë funksional EPRMB dhe 7 prej tyre janë trajnuar, kurse që të dhjetat janë njoftuar nga MASHT rreth instrumenteve për parandalim të braktisjes. Masat kryesore që ndërmarrin EPRMB në këto shkolla janë takimet me prindër.

ZKKK e kësaj komune nuk ka deklaruar se sa ka buxhet të ndarë për aktivitetet e parapara për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

5.5. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit

Në komunën e Prizrenit gjatë vitit shkollor 2017/2018 nuk ka pasur asnjë fëmijë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë në edukimin parashkollor, ndërkaq në klasën parafillore ishin të përfshirë 44 fëmijë. Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët ishin të përfshirë gjithsej 631 nxënës, përdërisa në arsimin e mesëm të lartë, numri zvogëlohet dukshëm në vetëm 61 nxënës.¹⁴ Ngjashëm si në komunat tjera, edhe në komunën e Prizrenit, shqetësim mbetet pjesëmarrja e ulët e nxënësve nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parashkollor dhe arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu, shqetësues mbetet sukcesi jo i mirë i nxënësve krahasuar me mesataren e përgjithshme të nxënësve nga komuniteti shumicë.

Arsimi përbën një ndër fushat prioritare në planin lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit dhe si i tillë parasheh një numër të aktiviteteve të cilat shpjen në përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë, nivelit të përfshirjes dhe përmirësimit të suksesit të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Komunën e Prizrenit. Disa nga aktivitetet e parapara në kuadër të këtij objekti strategjik janë: organizimi i fushatave vetëdijësuese për të luftuar diskriminimin dhe rëndësinë e arsimit, në veçanti fushata vetëdijësuese për rëndësinë e edukimit parashkollor, ofrimi i programeve të përsheptuara dhe mësimin plotësues, sigurimi i materialeve shkollore, takime me prindër, trajnimi i mësimdhënësve për qasje bashkëkohore, ndarja e bursave për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian e të tjera.¹⁵

Ngjashëm si në komunat tjera, për të eksploruar sado pak zbatimin e aktiviteteve të lartëcekura të parapara në planin lokal të veprimit të Komunës së Prizrenit, janë intervistuar drejtor të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta si dhe përfaqësues të ZKKK-së të cilët janë pyetur për aspekte të ndryshme të cilat lidhen me realizimin e aktiviteteve.

Në këtë drejtim, të gjeturat nga këto intervista tregojnë se Komuna e Prizrenit nuk ofron masa lehtësuese për pjesëmarrjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar si:

14 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018.

15 Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Prizrenit, http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1447/plv_per_komunitete_-_prizren_-_alb.pdf

sigurimi i materialeve shkollore, sigurimi i transportit falas për nxënësit që banojnë larg objekteve shkollore, ofrimi i programeve të përsheptuara për përfshirjen e të rriturve si dhe ofrimi i mësimi plotësues. Për më shumë, Komuna e Prizrenit nuk identifikon numrin e fëmijëve për regjistrim në arsimin e detyrueshëm. Megjithatë, sipas përfaqësuesve të ZKKK-së, Komuna ofron bursa për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët janë të përfshirë në arsimin e lartë.

Sa i përket organizimit të fushatave vetëdijësuese mbi rëndësinë e shkollimit, Komuna ka organizuar 5-6 fushata vetëdijësuese me prindër të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian.

Për më shumë, krijimi i një ambienti gjithëpërfshirës dhe jo diskriminues luan rol të rëndësishëm në përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë dhe shoqëri, prandaj trajnimi i mësimdhënësve për gjithëpërfshirje është i domosdoshëm. Në këtë drejtim, pjesa më e madhe e mësimdhënësve të përfshirë në këtë hulumtim (rreth 70%) shprehën se gjatë vitit shkollor 2017/2018 nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim për gjithëpërfshirje, kuptim të kulturave të ndryshme dhe qasjen ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Për më shumë hollësi lidhur me pjesëmarrjen e mësimdhënësve të Komunës së Prizrenit në trajnime, shih tabelën në vijim.

Tabela 16. Trajnimet e ndjekura nga mësimdhënësit në Komunën e Prizrenit

	Trajnime që ndërlidhen me mësimdhënie në një klasë diverse		Trajnime që ndërlidhen me kuptimin e kulturave të ndryshme		Trajnime që ndërlidhen me qasjen ndaj nxënësve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian	
	%	NUMRI	%	NUMRI	%	NUMRI
Po	24%	9	24%	9	27%	10
Jo	54%	20	54%	20	51%	19
Pa përgjegje	22%	8	22%	8	22%	8
Gjithsej	100%	37	100%	37	100%	37






Ngjashëm, sa i përket organizimit të aktiviteteve lidhur me diversitetin, 35% e mësimdhënësve kanë deklaruar se në shkollën e tyre nuk është organizuar asnjë aktivitet i ndërlidhur me diversitetin, 41% kanë deklaruar se janë organizuar 1-2 aktivitete, 14% kanë deklaruar se në shkollën e tyre janë organizuar 3-4 aktivitete dhe 11% kanë deklaruar se janë organizuar 5-6 aktivitete. Disa nga aktivitetet e realizuara në këto shkolla ishin aktivitete kulturore-sportive ose gara, dhe shumë pak lidhur me diversitetin. Po ashtu, shumica e mësimdhënësve (87%), kanë pohuar që në orë mësimore nuk flitet asnjëherë për historinë dhe kulturën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Për më tepër, ekziston një pajtueshmëri në mes të mësimdhënësve të intervistuar se në shkollat e tyre nuk ka diskriminim ndaj nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. E njëjta konfirmohet edhe nga për-

faqësuesit e ZKKK të cilët kanë deklaruar se gjatë vitit të fundit nuk është raportuar asnjë rast i diskriminimit. Megjithatë, duhet theksuar se kjo e dhënë paraqet vetëm perceptimin e tyre, pasi që gjatë këtij viti në media janë raportuar raste të ndryshme të diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duke dëshmuar që ky fenomen është ende i pranishëm në shoqërinë kosovare.

Në anën tjetër, përveç nivelit jo të kënaqshëm të përfshirjes së fëmijëve/nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelet e edukimit parashkollor dhe arsimit të mesëm të lartë, një shqetësim tjetër konsiderohet të jetë suksesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve krahasuar me mesataren e përgjithshme të nxënësve të komunitetit shumicë. Në këtë drejtim, pjesa me e madhe e mësimitdhënësve të intervistuar shprehen se nxënësit e këtyre komuniteteve marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga shkolla, megjithatë, performanca e tyre është kaluese apo e mirë. Për më shumë lidhur me përgjigjet e mësimitdhënësve mbi suksesin e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian, shih tabelën në vijim.

Tabela 17. Performanca e përgjithshme e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

	NUMRI	%	
Kaluese	16	43.2	
Mirë	13	35.1	
Shumë mirë	6	16.2	
Shkëlqyeshëm	2	5.4	
Gjithsej	37	100.0	

Të pyetur nëse mësimitdhënësit e komunës së Prizrenit të cilët punojnë me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian përdorin metoda të ndryshme të punës dhe organizojnë aktivitete që e bëjnë më tërheqës procesin edukativo-arsimor, mësimitdhënësit shprehen se përdorin metoda bashkëkohore, shfrytëzojnë teknologjinë, bëjnë punë eksperimentale e të tjera. Për më shumë hollësi rreth metodave të punës, shih tabelën përmbledhëse në vijim.

Tabela 18. Metodatat e punës së mësimdhënësve në Komunën e Prizrenit

Sa shpesh përdoren metodatat e mëposhtme të punës?	Asnjëherë		Më pak se një herë në muaj		Të paktën një herë në muaj		Të paktën një herë në javë		Të paktën një herë gjatë orës mësimore		Gjithsej	
	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%
Sa shpesh mësojnë nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian përmes teknologjisë në klasë (video, internet, kompjuter)?	0	0	17	45.9	14	37.8	6	16.2	0	0	37	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë punë eksperimentale ose praktike?	0	0	9	24.3	15	40.5	11	29.7	2	5.4	37	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian lexojnë në qetësi?	0	0	14	37.8	4	10.8	11	29.7	8	21.6	37	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian lexojnë me zë?	1	2.7	13	35.1	6	16.2	10	27	7	18.9	37	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian shkruajnë hartime dhe raporte në bazë të hulumtimeve?	0	0	2	5.4	30	81.1	4	10.8	1	2.7	37	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë prezentime para klasës?	0	0	2	5.4	3	8.1	16	43.2	16	43.2	37	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian punojnë në projekte të pavarura dhe afatgjata?	0	0	5	13.5	22	59.5	10	27	0	0	37	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian debatojnë për idetë e tyre ose i shpjegojnë ato në forma të tjera?	0	0	0	0	3	8.1	7	18.9	27	73	37	100
Sa shpesh nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian përdorin punëdore ose modele për zgjidhjen e problemeve.	0	0	8	21.6	18	48.6	9	24.3	2	5.4	37	100

Fenomeni i braktisjes së shkollimit është i pranishëm edhe në Komunën e Prizrenit. Në këtë drejtim, nga të gjitha shkollat pjesëmarrëse në këtë hulumtim, në përgjithësi 4 nxënës, 3 prej të cilëve vajza nga komuniteti rom dhe 3 nxënës, prej të cilëve 1 vajzë nga komuniteti ashkali kanë braktisur shkollimin. Faktor kryesorë që ndikojnë në braktisjen e shkollimit janë gjendja e vështirë socio-ekonomike, vetëdijesimi i ulët i prindërve për rëndësinë e shkollimit, martesat e hershme dhe emigrimi. Për zvogëlimin e rasteve të braktisjes shkollat kanë ndërmarrë masa të ndryshme kryesisht, takime me prindër, fushata vetëdijësuese, ofrimi i bursave dhe ndihmës sociale. Në anën tjetër, Komuna e Prizrenit nuk e ka funksional EPRMB, kurse 8 nga 10 shkollat e intervistuar e kanë EPRMB funksionale, dhe janë njoftuar nga MASHT rreth instrumenteve për parandalim të braktisjes.

5.6. Arsimimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Lipjanit

Në Komunën e Lipjanit përfshirja e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar është në nivel jo të kënaqshëm. Sipas statistikave për arsim në vitin 2017/2018 në edukimin parashkollor nuk ishte i përfshirë asnjë fëmijë nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ndërkaq në arsimin parafillor ishin të përfshirë gjithsej 39 fëmijë rom dhe ashkali. Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët ishin të përfshirë 399 nxënës rom dhe ashkali, përderisa në arsimin e mesëm të lartë ishin të përfshirë vetëm 41 nxënës të këtyre komuniteteve.¹⁶ Nga këto të dhëna mund të konstatohet se niveli i përfshirjes së nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parashkollor, në klasën parafillore dhe në shkollimin e mesëm të lartë në Komunën e Lipjanit është shumë i ulët krahasuar me përfshirjen në arsimin e detyrueshëm.

Për më shumë, ngjashëm si në të gjitha komunat tjera, përveç nivelit jo të kënaqshëm të përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar në Komunën e Lipjanit, shqetësim tjetër konsiderohet edhe suksesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë, megjithëse për këtë nuk ka statistika të sakta zyrtare.

Në këtë drejtim, me qëllim të avancimit të pozitës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit, Komuna e Lipjanit në planin lokal të veprimit ka paraparë si objektivi strategjik rritjen e përfshirjes dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar. Për arritjen e këtij objektivi janë paraparë një varg aktiviteteve si: organizimi i fushatave informuese për ndërgjegjësimin e prindërve për rëndësinë e shkollës dhe regjistrimin e tyre në shkollë, organizimi i fushatave informuese dhe regjistrimi i fëmijëve dhe nxënësve në institucionet parashkollore publike, mbështetja e nxënësve të shkollave të mesme me bursa, ofrimi i pakove shkollore, organizimi i mësimit plotësues në shkolla për nxënësit me sukses jo të mirë e të tjera.¹⁷

Ndonëse përfaqësuesit e ZKKK-së nuk kanë ofruar të dhëna sa i përket masave si mbështetja financiare, lehtësim të procedurave për regjistrim në arsimin parauniversitar, rezervim të vendeve në shkolla për nxënësit

¹⁶ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018.













¹⁷ Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Lipjanit, http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1384/plv_per_komunitete_-_lipjan_-_alb.pdf

rom, egjiptian dhe ashkali, disa nga masat lehtësuese të cilat i ndërmerr komuna janë: lehtësimi i masave për regjistrimin e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në institucionet parashkollore dhe ofrimi i programeve të përshpejtuara për të rriturit. Në anën tjetër, Komuna nuk ofron bursa për studentët rom, ashkali dhe egjiptian që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë.

Drejtorët e të gjitha shkollave të komunës së Lipjanit pjesëmarrëse në këtë hulumtim kanë deklaruar se organizojnë mësimin plotësues, kryesisht për lëndët e gjuhës shqipe dhe matematikës. Po ashtu, në katër prej shkollave ofrohet përgatitje intensive, kurse ose orë plotësuese për përgatitje për testin e semi-maturës dhe maturës për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian.

Sa i përket trajnimeve të mësimdhënësve për gjithëpërfshirje, shumica e mësimdhënësve kanë përfunduar trajnime për gjithëpërfshirje, mësimdhënie në klasë diverse dhe kuptimin e kulturave të ndryshme. Për më shumë lidhur me trajnimet e mësimdhënësve, shih tabelën në vijim.






Tabela 19. Trajnime të ndjekura nga mësimdhënësit në Komunën e Prizrenit

	Trajnime që ndërlidhen me mësimdhënie në një klasë diverse		Trajnime që ndërlidhen me kuptimin e kulturave të ndryshme		Trajnime që ndërlidhen me qasjen ndaj nxënësve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian	
	%	NUMRI	%	NUMRI	%	NUMRI
Po	69% 	24	66% 	23	69 	24
Jo	9% 	3	9% 	3	9 	3
Pa përgjegje	23% 	8	26% 	9	23 	8
Gjithsej	100% 	35	100% 	35	100 	35

Për më shumë, mësimdhënësit janë shprehur se në shkollat e tyre janë organizuar aktivitete që lidhen me diversitetin. Aktivitetet e organizuara ishin të karakterit kulturor-sportiv ose gara të ndryshme. Po ashtu, 31% e mësimdhënësve kanë deklaruar se në orët mësimore nuk flitet asnjëherë për kulturën e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian, ndërsa shumica dërmuese kanë thënë se gjatë orëve mësimore flasin për kulturën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Ngjashëm si në komunat tjera, shqetësim mbetet sukcesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve, krahasuar me suksesin e përgjithshëm të nxënësve nga komuniteti shumicë. Për më shumë hollësi lidhur me performancën e përgjithshme të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian, shih tabelën në vijim.

Tabela 20. Performanca e përgjithshme e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

	NUMRI	%	
Kaluese	2	5.7	
Mirë	8	22.9	
Shumë mirë	19	54.3	
Shkëlqyeshëm	6	17.1	
Gjithsej	35	100.0	

Braktisja e shkollimit nga nxënësit e radhëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është prezente edhe në Komunën e Lipjanit. Nga intervistat me drejtorët e shkollave pjesëmarrëse në këtë hulumtim është kuptuar se 7 nxënës (6 prej të cilëve femra) kanë braktisur shkollimin. Shkaqet kryesore të braktisjes së shkollimit nga nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian është gjendja e vështirë ekonomike, martesat e hershme, dhe vetëdija e ulët e prindërve për rëndësinë e shkollimit.

Si rrjedhojë, dy nga masat të cilat janë ndërmarrë për parandalim të braktisjes janë: takimet me prindër dhe organizimi i fushatave vetëdijësuese. Për më tepër, EPRMB në nivel komunal nuk është funksional, ndërsa në nivel të shkollave këto ekipe janë funksionale dhe janë njoftuar nga MASHT rreth instrumenteve për parandalim të braktisjes.

Komuna e Lipjanit ka buxhet prej 2,000 EUR për realizimin e aktiviteteve për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ku buxheti komunal është burim i financimit. Investimet kryesore ku dedikohet kjo shumë janë subvencionet.

QENDRAT MËSIMORE


6. Qendrat Mësimore

Aspekt tjetër tejet i rëndësishëm në rritjen e përfshirjes në arsim, për parandalimin e braktisjeve të shkollimit dhe për përmirësimin e suksesit të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë, janë qendrat mësimore. Ky konstatim mbështetet në faktin se Qendrat Mësimore ofrojnë edukim parashkollor, edukim parafillor, si dhe ofrojnë mësim shtesë, orë plotësuese, ndihmë për kryerje të detyrave të shtëpisë, si dhe aktivitete të tjera sociale e edukative për fëmijët dhe nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian. Përveç këtyre, Qendrat Mësimore shpeshherë shërbejnë edhe si urë lidhëse ndërmjet familjeve, komunitetit dhe institucioneve edukativo-arsimore.

Qendrat Mësimore funksionojnë me bazë në komunitet dhe me bazë në shkollë. Në komuna të ndryshme në Kosovë ku jetojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë themeluar Qendra Mësimore me qëllim të përfshirjes së këtyre komuniteteve në sistemin arsimor. Nismat për themelimin e Qendrave Mësimore nga organizatat jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare merrnin për bazë shkallën tejet të ulët të vijimit dhe realizimit të shkollimit nga fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe nivelin e pakënaqshëm të performancës së tyre në shkollë dhe mungesën e përfshirjes sociale.


Aktualisht, rreth 83 Qendra Mësimore veprojnë në 20 komuna të Kosovës, kryesisht në komunat ku jetojnë shumica e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto qendra udhëhiqen nga 10 organizata të shoqërisë civile në Kosovë me mbështetje financiare të donatorëve ndërkombëtar. Numri më i madh i Qendrave Mësimore është në komunat e Gjakovës, Prizrenit, Pejës dhe Lipjanit. Në figurën 1 paraqitet harta e Qendrave Mësimore në Kosovë.

Figura 1. Harta e Qendrave Mësimore në Kosovë




Sipas të dhënave të ofruara nga organizatat jo-qeveritare që menaxhojnë Qendrat Mësimore, janë gjithsej 5,555 fëmijë që vijojnë aktivitetet në Qendra Mësimore, ku numri i fëmijëve nga të dy gjinitë është pothuajse i barabartë. Komunitet e Fushës Kosovës, Gjakovës dhe Shtimes kanë numrin më të madh të fëmijëve që vijojnë aktivitetet në Qendra Mësimore.

Figura 2. Numri i fëmijëve në Qendra Mësimore sipas gjinisë



Qendrat Mësimore operojnë kryesisht nëpërmjet mbështetjes financiare nga donatorët, dhe kjo mbështetje nuk është e qëndrueshme. Buxheti vjetor i të gjitha Qendrave Mësimore është €1,807,750.40, ndërsa mesatarja e shpenzimeve vjetore të gjitha Qendrave Mësimore për kokë nxënësi është 325,4 EUR apo 27,1 EUR në muaj. Përkundër që në Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali parashihet mbështetja e punës së Qendrave Mësimore, MASHT nuk ka ndarë mjete financiare për këtë qëllim. Megjithatë, në vitet e fundit, janë nënshkruar një numër i madh i marrëveshjeve të mirëkuptimit me autoritetet qendrore dhe lokale, nëpërmjet të cilave autoritetet lokale janë zotuar për të siguruar hapësira shkollore për Qendrat Mësimore, që të mund të realizojnë aktivitetet e tyre. Disa komuna kanë ofruar po ashtu mbështetje për furnizim me qymyr për sigurimin e ngrohjes në hapësirat e Qendrave Mësimore gjatë muajve të dimrit.





















Figura 3. Mbështetja e Komunavë për Qendra Mësimore (të dhënat nga 6 Komunat e monitoruara)



Në shumicën e Qendrave Mësimore që menaxhohen nga organizatat e shoqërisë civile personeli i angazhuar është nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Komunat e Fushës Kosovës, Gjakovës dhe Shtimes kanë numrin më të madh të fëmijëve që vijojnë aktivitetet në Qendra Mësimore. (Figura 4).

Figura 4. Numri i fëmijëve në Qendra Mësimore sipas komunave

Fushë Kosovë	895	
Gjakovë	893	
Shtime	706	
Prizren	403	
Lipjan	359	
Ferizaj	356	
Mitrovicë	346	
Pejë	290	
Obiliq	241	
Podujevë	164	
Graçanica	164	
Suharekë	161	
Istog	155	
Rahovec	103	
Vushtrri	90	
Klinë	84	
Prishtinë	48	
Gjilan	42	
Kamenicë	34	
Novobërd	31	

Në vitin shkollor 2017/2018, në bazë të statistikave të arsimit në Kosovë, në arsimin parauniversitar janë 6662 nxënës rom, ashkali dhe egjiptian. Ndërkaq, Qendrat Mësimore i vijnë 4992 fëmijë rom, ashkali dhe egjiptian. Në bazë të llogaritjeve, rezulton që 75% e fëmijëve të përfshirë në sistemin arsimor vijnë aktivitetet plotësuese në Qendra Mësimore. Megjithatë, kjo llogaritje është e kufizuar për shkak se një numër i madh i fëmijëve të moshës (0-5 vjeç), i vijnë programet e edukimit parashkollor në Qendra Mësimore dhe të njëjtit nuk reflektohen në të dhënat zyrtare për arsim.

Tabela 21. Përfshirja e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në Qendra Mësimore

Komuna	Nxënës rom, ashkali dhe egjiptian në arsim parauniversitar ¹⁸	Nxënës rom, ashkali dhe egjiptian në Qendra Mësimore ¹⁹	Përfshirja në Qendra Mësimore %
1 Deçan	98	0	0%
2 Gjakovë	1553	893	58%
3 Gjilan	1	42	Nuk aplikohet
4 Istog	417	155	37%
5 Klinë	279	84	30%
6 Fushë Kosovë	589	895	Nuk aplikohet
7 Kamenicë	198	34	17%
8 Mitrovicë	60	346	Nuk aplikohet
9 Lipjan	478	359	75%
10 Novobërdë	0	21	Nuk aplikohet
11 Obiliq	164	241	Nuk aplikohet
12 Rahovec	148	103	70%
13 Pejë	641	290	45%
14 Podujevë	166	164	99%
15 Prishtinë	78	48	62%
16 Prizren	738	403	55%
17 Skenderaj	4	0	0%
18 Shtime	157	143 ²⁰	91%
19 Suharekë	118	161	Nuk aplikohet
20 Ferizaj	757	356	47%
21 Viti	2	0	0%
22 Vushtrri	9	90	Nuk aplikohet
23 Malishevë	7	0	0%
24 Graçanicë	/	164	/
GJITHSEJ	6662	4992	75%

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018²¹ dhe përlogaritjet e autorëve

- 18 Përkundër faktit se MASHT mbledh të dhënat nga shkollat përmes një sistemi të avancuar të menaxhimit të informatave (SMIA), në të cilin secila shkollë ka qasje dhe raporton të dhënat përkatëse çdo gjysmëvjetor, ka shpërputhje në të dhënat që kanë OJQ-të dhe shkollat në numrin e nxënësve sipas etnisë.
- 19 Këto të dhëna përfshijnë edhe fëmijët që vijojnë edukimin parashkollor në qendrat mësimore, që janë kryesisht në vendbanimet e tyre dhe funksionojnë kryesisht për adresimin e nevojave të tyre dhe të njëjtit nuk janë të reflektuar në sistemin e arsimit parauniversitar.
- 20 Në Qendrën Mësimore në Shtime, që menaxhohet nga Balkan Sunfloëers Kosovo vijojnë mësimin plotësues dhe aktivitetet e Qendrës Mësimore 620 nxënës, përfshirë nxënësit shqiptarë. Ndërkaq janë 57 nxënës rom dhe ashkali që vijojnë këtë Qendër Mësimore, prej të cilëve 30 djem dhe 27 vajza.
- 21 Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018. I qasshëm në <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/07/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2017-18.pdf>

Në komunat Glogoc, Dragash, Kaçanik, Kllkot, Hani i Elezit, Partesh, Ranillug, Junik, Shtërpçë, Mamushë nuk ka asnjë nxënës rom, ashkali dhe egjiptian në institucionet publike parauniversitare, në asnjë nivel të arsimimit dhe po ashtu nuk ka asnjë Qendër Mësimore që funksionon në këto komuna.


Një ilustrim më gjithëpërfshirës me mbi 1200 fëmijë është realizuar nga projekti i financuar nga BE-ja “EU SIMRAES II” që zbatohet nga KFOS në bashkëpunim me KEC dhe gjashtë (6) OJQ partnere që menaxhojnë me Qendra Mësimore. Në vitin shkollor 2016/2017 është krahasuar nota tabelën 22.

Tabela 22 : Hendeku i notës mesatare ndërmjet nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian dhe atyre të komunitetit shumicë në arsimin e obligueshëm

Viti shkollor 2016/2017 Lokacionet	Nota mesatare Nxënës rom, ashkali dhe egjiptian	Nota mesatare Nxënës nga komuniteti shumicë	Hendeku i notës mesatare
Qendra Mësimore “Jeta e Re”, Prizren	2.76	4.29	1.53
Qendra Mësimore Piranë, Prizren	2.71	4.04	1.33
Qendra Mësimore “Roma Mahalla”, Rahovec	2.77	3.77	1.01
Qendra Mësimore në Gurakoc, Istog	3.06	4.14	1.08
Qendra Mësimore në Serbobran, Istog	3.63	4.71	1.08
Qendra Mësimore në Brekoc, Gjakovë	2.89	4.50	1.61
Qendra Mësimore në Fushë Kosovë	2.83	3.79	0.97
Qendra Mësimore -Ndërtesa Sociale në Plemetin, Obiliq	2.74	3.52	0.78
Qendra Mësimore në fshatin Plemetin, Obiliq	2.89	4.55	1.66
Qendra Mësimore Roma Mahalla, Mitrovicë	2.52	3.69	1.18
MESATARJA	2.88	4.1	1.22


Nga 24 koordinatorë të intervistuar të Qendrave Mësimore, 17 prej tyre kanë deklaruar që qendrat e tyre punojnë pesë (5) apo më shumë herë në javë, kurse shtatë (7) të tjerë kanë deklaruar që në Qendrat Mësimore punohet 3 deri 4 herë në javë.

Figura 5. Orari i punës në Qendra Mësimore




Meqenëse të gjitha këto qendra bashkëpunojnë me shkolla, koordinatorët e tyre janë pyetur për shpeshinë e takimeve ndërmjet Qendrave Mësimore dhe përfaqësuesve të shkollave. Shumica e qendrave (21) mbajnë takime me përfaqësues të shkollave të paktën një herë në muaj. Të tjerat mbajnë takime çdo tre muaj (2) apo një herë në gjysmëvjetor (1).

Figura 6. Takime ndërmjet Qendrave Mësimore dhe shkollave



Sipas koordinatorëve të Qendrave Mësimore, mbështetja në kryerjen e detyrave të shtëpisë (11) dhe pajisja me materiale shkollore (10) janë dy nevojat më të mëdha me të cilat përballen nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian që marrin pjesë në këto qendra. Pas tyre radhiten nevoja për aktivitete rekreative (7) dhe ofrimi i shujtave ushqimore (6).


Figura 7. Nevojat më të mëdha të nxënësve në Qendra Mësimore



Shumica e koordinatorëve të intervistuar (17) deklaruan që hapësira me të cilat disponojnë Qendrat Mësimore janë të mjaftueshme për realizim të aktiviteteve. Një numër edhe më i lartë i tyre (18) pohojnë se Qendrat Mësimore ku ata punojnë kanë mbështetje nga autoritetet komunale, posaçërisht mbështetje në ofrim të hapësirës fizike brenda shkollave, si dhe ngrohje dhe transport të nxënësve.

Prindërit e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian kanë deklaruar që fëmijët e tyre kanë miq të komuniteteve tjera në Qendra Mësimore (93 përqind). Vetëm 6 përqind e prindërve kanë thënë që fëmijët e tyre nuk shoqërohen me fëmijë të komuniteteve tjera në Qendra Mësimore. Rreth 92 përqind e prindërve po ashtu kanë deklaruar që ata ftohen nga Qendrat Mësimore në aktivitete që ato i organizojnë me prindër. Më shumë se gjysma e prindërve (59 përqind) kanë thënë që marrin pjesë rregullisht në këto aktivitete, 34 përqind marrin pjesë kohë pas kohe, kurse vetëm 7 përqind e prindërve nuk marrin kurrë pjesë në aktivitete të tilla.

Figura 8. A kanë miq jo rom, ashkali apo egjiptian fëmijët tuaj në Qendër Mësimore?



PUNËSIMI DHE MIRËQENIA SOCIALE

7. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Papunësia dhe kushtet socio-ekonomike mbeten dy nga problemet më të mëdha me të cilat përballen shoqëria kosovare. Sipas anketës së Pulsit Publik, kushtet socio-ekonomike konsiderohen si problem kyç për 65% të kosovarëve.²² Përkundër nivelit të lartë të papunësisë në Kosovë, krahasuar me popullatën e përgjithshme, numri i papunësisë tek pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është shumë më i lartë. Varfëria ndër komunitetet rom, egjiptian, ashkali është tipar karakterizues. Niveli i ulët i edukimit, shkalla e ulët e aftësive, bashkë me mundësitë e ulëta për t'u integruar në tregun e punës, janë ndër arsyt kryesore që e mirëmbajnë varfërinë në këto komunitete.

Të ardhurat e familjes në këto komunitete janë të mjaftueshme vetëm sa për të jetuar. Niveli i të ardhurave mujore, përfshirë këtu pagat, SNS, pensionet e familjeve të këtyre komuniteteve janë jashtëzakonisht të ulëta.

Numri i punëkërkuessve të regjistruar vetëm në vitin 2018 ishte 493, prej të cilëve 164 ishin rom, 212 ashkali dhe 117 egjiptian. Përderisa numri i përgjithshëm i gjithë punëkërkuessve të regjistruar aktiv rom është 1,797, ashkali 2715 dhe 856 egjiptian. Dallimet më të mëdha në mesin e punëkërkuessve të regjistruar në vitin 2018 vërehen për komunitetin ashkali në grupmoshë, ku dallimet më të mëdha janë ata të grupmoshës 15-24, ndërsa për komunitetin rom ata të grupmoshës 25-39 vjeç. Punëkërkuessit e komunitetit egjiptian nuk dallojnë shumë për nga grupmosha.²³

Tabela 23. Punëkërkuessit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian sipas grupmoshave

	Grupmosha 15-24	Grupmosha 25-39	Grupmosha 40-54	Grupmosha 55+
Rom	61	66	29	8
Ashkali	107	60	35	10
Egjiptian	36	41	35	5

22 Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Pulsi Publik XIII, Tetor 2017.

23 Të dhëna administrative nga APRK.

Nga numri i përgjithshëm i punëkërkesve rom, ashkali dhe egjiptian të regjistruar në vitin 2018, rreth 55%, apo 271 nga 493 punëkërkes janë të pakualifikuar ose me shkollë fillore (30%, apo 187 nga 493 punëkërkes).²⁴ Një numër shumë i vogël i punëkërkesve nga këto komunitete e kanë të përfunduar arsimin e mesëm profesional, dhe ky numër është më i madh tek pjesëtarët e komunitetit ashkali. Për më shumë të dhëna rreth kësaj, shih tabelën në vijim.

Tabela 24. Niveli i arsimimit i punëkërkesve të regjistruar rom, ashkali dhe egjiptian

Niveli i edukimit	Rom			Ashkali			Egjiptas		
	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M
I pa shkolluar	100	47	53	131	64	67	44	18	26
Klasët I -IX (Shkolla fillore)	46	20	26	56	16	40	45	17	28
Arsim i mesëm profesional	14	7	7	20	7	13	15	6	9
Shkollë e mesme gjimnaz	3	0	3	3	1	2	4	0	4
Bachelor	1	1	0	2	0	2	9	4	5
Master	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PhD	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	164	75	89	212	88	124	117	45	72

Dallime të punëkërkesve ka edhe nëse merret parasysh gjinia. Në mesin e punëkërkesve të regjistruar në vitin 2018, dominojnë meshkujt me 57.4%. Sidoqoftë, krahasuar me vitin 2017 ky hendek gjinor është zvogëluar për 3.0%. Nëse merret parasysh numri i të gjithë punëkërkesve të regjistruar aktiv rom, ashkali dhe egjiptian, ka dallime sa i përket gjinisë: 61% janë meshkuj apo 3,523 nga 5,366 punëkërkes aktiv, dhe 39% femra apo 2,113 nga 3,523 punëkërkes.

Në komunën e Ferizajt janë gjithsej 713 punëkërkes të regjistruar aktiv; në Fushë Kosovë 659; në Gracanicë 234; në Gjakovë 677; në Lipjan 375; dhe në Prizren 948.²⁵

24 Të dhëna administrative nga APRK.

25 Të dhëna administrative nga APRK.

Tabela 25. Numri i punëkërkuessve të regjistruar aktiv në gjashtë komunat e Kosovës

Komuna	Rom			Ashkali			Egjiptas		
	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M
Ferizaj	38	15	23	673	257	416	2	1	1
Fushë Kosovë	64	20	44	578	170	408	17	6	11
Gracanicë	223	106	117	11	3	8	0	0	0
Gjakovë	132	58	74	162	60	102	383	178	205
Lipjan	48	22	26	327	127	200	0	0	0
Prizren	474	225	249	98	38	60	1	0	1
GJITHSEJ	979	446	533	1849	655	1194	403	185	218

Në përgjithësi, niveli i informimit të punëkërkuessve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në raport me shërbimet e ofruara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organizata tjera për punësim dhe trajnime profesionale, është i ulët. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve gjithashtu përballen me pengesa të shumta lidhur me mundësitë e tyre për të përfituar nga masat aktive të tregut të punës (MATP), pasi që kriteret për disa skema, siç është niveli i arsimimit, janë pothuajse përjashtuese për këto komunitete.

MPMS për punëkërkuessit e regjistruar në Zyrat e Punësimit ofron shërbime këshillimi, ndërmjetësimi në punë, trajnime profesionale, dhe pjesëmarrje në skema të ndryshme të masave aktive të tregut të punës. Masat aktive kanë për qëllim zbutjen e papunësisë. Sigurimi i pjesëmarrjes në MATP për komunitetet jo shumicë zakonisht sigurohet përmes kuotës për këto komunitete. Masat aktive të tregut të punës përbëjnë: masën «Punë publike», që ofron punësim afatshkurtër; masën “Tranim në Punë” që përfshin trajnimin nga një punëdhënës për punëkërkuessin gjatë angazhimit në punën produktive; masa “Subvencionimi i pagave” që krijon mundësi për punësim duke subvencionuar punëdhënësit, në mënyrë që ata t’i rekrutojnë pastaj në baza afatgjata; masa e “Vetëpunimësit” që ofron mundësi për të papunësuarit e regjistruar për të filluar një aktivitet biznesi dhe masa e “Skemës së Praktikës” që ofron mundësi të përfitimit të përvojës në mjedisin e punës për fushë të caktuar të karrierës që punëkërkuessi dëshiron të hyj.

Në vitin 2018, nga gjithsej 2,319 përfitues nga MATP, vetëm 72 prej tyre, apo 3%, janë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Nga gjithsej 524 përfitues nga skema Punë Publike, 4 janë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Nga gjithsej 424, që kanë ndjekur trajnimin për punë, 22 prej tyre janë pjesëtarë të këtyre komuniteteve. Për më shumë, nga 275 përfitues të subvencioneve për paga, 11 prej tyre janë pjesëtarë të këtyre tre komuniteteve. Po ashtu, nga 228 përfitues të politikës për vetëpunësim, 24 janë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, ndërsa nga 868 përfitues të punës praktike, 11 janë pjesëtarë të këtyre komuniteteve.

Krahasuar me vitin e kaluar, vërehet një ulje prej 1% e përfituesve të këtyre tri komuniteteve nga PATP. Përderisa në vitin 2017, nga 2800 përfitues 112 (apo 4%) ishin pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, bashkë me numrin e përfituesve të përgjithshëm, ka rënë edhe numri i përfituesve nga këto tri komunitete.

Tabela 26. Përfituesit e MATP, sipas përkatësisë etnike dhe sipas llojit në vitin 2018

Etniciteti	Punë Publike			Trajnim në punë			Subvencionim i pagave			Vetëpunësim			Skema e praktikës		
	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M
Shqiptar	507	20	487	365	215	150	249	108	141	184	41	143	817	495	322
Kroat	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Turk	0	0	0	4	2	2	1	1	0	2	0	2	5	2	3
Malazez	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Rom	1	0	1	8	2	6	2	0	2	5	2	3	3	0	3
Serb	11	1	10	20	10	10	6	2	4	7	3	4	25	16	9
Boshnjak	1	0	1	3	2	1	4	2	2	9	1	8	10	4	6
Ashkali	3	0	3	12	6	6	5	1	4	12	0	12	7	3	4
Tjeter	0	0	0	10	4	6	4	0	4	2	0	2	0	0	0
Egjiptas	0	0	0	2	1	1	4	0	4	7	2	5	1	1	0
GJITHSEJ	524	21	503	424	242	182	275	114	161	228	49	179	868	521	347

Burimi: Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit, APRK, Nëntor 2018

Ndër shërbimet kryesore të Agjencisë për Punësim të Kosovës, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është edhe Shërbimi për Punësim. Sipas të dhënave të MPMS, në vitin 2018 janë realizuar 83 ndërmjetësime të rregullta për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, që përbën 2% të numrit të përgjithshëm të ndërmjetësimeve të rregullta (Tabela 27). Ndonëse, numri i ndërmjetësimeve krahasuar me vitin 2017 është rritur për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, krahasuar me rritjen e përgjithshme të numrit të ndërmjetësimeve, vërehet një trend i rënies në përqindje të ndërmjetësimeve për këto komunitete, që nënkupton se rritja e ndërmjetësimeve për pjesëtarë të këtyre komuniteteve nuk është proporcionale me rritjen e përgjithshme.

Tabela 27. Ndërmjetësimet në punësim të rregullt në vitin 2018 dhe 2017²⁶

Etniciteti	Punësimi i rregullt					
	2017			2018		
	Gj	F	M	Gj	F	M
Shqiptar	2012	740	1272	2673	1077	1596
Kroat				0	0	0
Turk				15	11	4
Malazez				0	0	0
Rom				32	5	27
Serb	57	26	31	86	41	45
Boshnjak				32	17	15
Ashkali	27	5	22	19	8	11
Tjeter	62	33	29	32	7	25
Egjiptas	22	3	19	25	12	13
GJITHSEJ	2198	818	1380	2914	1178	1736

Trendi i përfshirjes në programet e aftësimin profesional ka shënuar rënie në dy vitet e fundit. Përderisa në vitin 2016, 301 kandidatë nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë trajnuar në QAP, në vitin 2017 ky numër ka pësuar rënie prej 44%, me vetëm 169 kandidatë. Ndërkaq, në vitin 2018 vetëm 116 kandidatë nga radhët e këtyre komuniteteve janë trajnuar në QAP, që paraqet 31.4% rënie krahasuar me vitin 2017 dhe 61.5% rënie krahasuar me vitin 2016.

26 Të dhëna administrative nga APRK.

Tabela 28. Pjesëtarët e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë në trajnime

Qendrat e Aftësisimit Profesional (QAP)	Rom	Ashkali	Egjiptian	Gjithsej
Mitrovicë	0	1	0	1
Pejë	9	11	12	32
Gjakovë	0	1	24	25
Prizren	16	2	0	18
Prishtinë	1	28	0	29
Ferizaj	0	11	0	11
Gjilan	0	0	0	0
GJITHSEJ	26	54	36	116

Burimi: APRK 2018

Nga të dhënat e mbledhura nga ZKKK e Komunës së Ferizajt, Fushë Kosovës, Lipjanit, Gjakovës, Prizrenit, dhe Graçanicës, kuptohet se MPMS ka ofruar subvencione për punësim dhe se qasja e pjesëtareve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shërbimet e punësimit është e lehtë dhe e kënaqshme. Po ashtu, të gjitha komunat e intervistuar kanë pohuar të kenë realizuar takime informuese gjatë vitit të fundit me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për llojet e skemave të mbrojtjes sociale.

Përveç Komunës së Graçanicës, zyrtarët e të gjithave komunave respektive janë shprehur se kanë bashkëpunim me Qendrën për Aftësim Profesional në komunat e tyre. Ndonëse zyrtarët e ZKKK-ve pohojnë të kenë ndërmjetësuar kandidatë për aftësim profesional në QAP, në asnjë komunë nuk dihet numri i ndërmjetësimeve për pjesëtarët e këtyre tri komuniteteve.

Komunat raportojnë sfida të ndryshme me të cilat përballen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në punësimin e tyre, kryesisht mos-informimi i tyre lidhur me mundësitë për punësim, mungesa e arsimimit, mungesa e dokumenteve, mungesa e vendeve të punës si dhe paragjykimet me të cilat përballen ata.

8. Përfundime dhe Rekomandime

Pjesëmarrja e nxënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin e arsimit ka shënuar rritje në 17 vitet e fundit, megjithatë, në krahasim me mesataren e përgjithshme, ky numër është mjaft i ulët. Përkundër që mungojnë të dhëna të sakta për numrin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në Kosovë, nga të dhënat/statistikat për arsimin në Kosovë mund të konstatohet se niveli i përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin e detyruar është i kënaqshëm, ndërsa përfshirja e tyre në edukimin parashkollor, klasën parafillore dhe shkollimin e mesëm të lartë është shumë i ulët.

Braktisja e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar, e në veçanti në nivelin e shkollimit të detyrueshëm (fillor dhe të mesëm të ulët) përbën një nga sfidat e fushës së arsimit me të cilat përballen Komunitatet. Shkaqet kryesore të braktisjes së shkollimit nga nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian janë gjendja e vështirë socio-ekonomike, vetëdijësimi i ulët i prindërve të këtyre nxënësve për rëndësinë e shkollimit, niveli i lartë i papunësisë, emigrimi e të tjera. Në këtë drejtim, shumë nga komunitetet nuk kanë hartuar ende plane për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit dhe në shumë komuna EPRMB nuk janë ende funksionale.

Për dallim nga viti paraprak, në vitin 2018 shkollat dhe ZKK-të kanë deklaruar se kanë organizuar fushata vetëdijësuese për rëndësinë e arsimit dhe rëndësinë e regjistrimit në kohë dhe vijimit të rregullt. Megjithatë, komunitetet ende janë prapa në ofrimin e masave lehtësuese për përfshirjen e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar. Ofrimi i transportit, i pakove shkollore, mbështetja financiare për blerjen e teksteve shkollore etj., janë disa nga masat që do ta zbutnin pamundësitë ekonomike që pengojnë vijimin e shkollimit për nxënësit e komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian. Megjithatë, disa nga komunitetet e intervistuar zbatojnë ndonjë nga këto masa. Për më tepër, gjuha rome nuk ofrohet në asnjë nga shkollat pjesëmarrëse në këtë hulumtim, dhe në 51% të rasteve, nuk diskutohet asnjëherë për kulturën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në klasa.

Trajnimet e vazhdueshme sigurojnë që mësimdhënësit vazhdimisht zhvillohen për të zbatuar metoda atraktive dhe për të siguruar gjithëpërfshirjen në klasë. Megjithatë, shqetësues është fakti që pothuajse vetëm gjysma e të gjithë mësimdhënësve pjesëmarrës në këtë hulumtim kanë ndjekur trajnime për mësimdhënie në klasë diverse, kuptimin e kulturave të ndryshme dhe qasje ndaj nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Qendrat Mësimore luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e përfshirjes dhe performancën e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë. Puna e këtyre qendrave ka rezultuar në vijim më të rregullt të nxënësve në shkollë, nota më të larta, shkallë më të ulët të braktisjes dhe rritje të përfshirjes sociale të fëmijëve rom, ashkali

dhe egjiptianë. Pavarësisht rolit të rëndësishëm të Qendrave Mësimore, vlerësohet se ato ballafaqohen me disa sfida, prandaj rekomandohet të ndërmerren masa në funksion të fuqizimit dhe përmirësimit të punës.

Nga të gjeturat e 10 Qendrave mësimore, për vitin shkollor 2016/2017, vërehet se ekziston një hendek prej 1.22 pikë të notës mesatare ndërmjet rezultateve mësimore të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian dhe atyre shumicë. Këtë e vërtetojnë edhe të dhënat e hulumtimit, ku 37% të mësimdhënësve nga gjashtë komunat e intervistuar kanë thënë që në krahasim me klasën, performanca e përgjithshme e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian është kaluese, kurse 45% kanë thënë që është e mirë.

Papunësia në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është shumë e lartë, krahasuar me komunitetet tjera. Duke krahasuar me vitet e kaluara, ndonëse vërehet një rritje në numrin e përfituesve nga PATP nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, krahasuar me numrin e përgjithshëm të rritjes, ky numër mbetet i ulët.

Mungesa e kualifikimeve rëndon nivelin e lartë të papunësisë nga rradhët e këtyre komuniteteve. Në këtë drejtim, nga numri i punëkërkuesve rom, ashkali dhe egjiptian, të regjistruar në vitin 2018, 55% prej tyre janë të pakualifikuar, dhe 30% me arsim fillor. Për më shumë, trendi i përfshirjes së pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në aftësim profesional ka pësuar rënie drastike në dy vitet e fundit (61.5%).

Ndonëse komunat e intervistuar kanë raportuar se organizojnë takime informuese dhe ofrojnë subvencione për punësim, ende raportohen sfida të ndryshme që i hasin pjesëtarët e këtyre komuniteteve sa i përket punësimit. Në këtë drejtim, mungesa e informimit, mungesa e shkollimit, mungesa e dokumenteve, paragjykimet me të cilat ata përballen, si dhe mungesa e vendeve të punës, vazhdojnë të mbetet sfidat kryesore me të cilat përballen pjesëtarët e këtyre komuniteteve sa i përket punësimit.

8.1. Rekomandimet

Duke u bazuar në të dhënat e MASHT për arsimin në Kosovë, edukimin parashkollor dhe parafillor e vijojnë një numër shumë i vogël i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo për faktin se çerdhet dhe kopshtet kanë kosto e cila nuk është e përballueshme për pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Për më shumë, përkundër që pjesëmarrja është më e mirë në arsimin e detyrueshëm, gjendja rëndohet në nivelet me të larta të arsimit. Në këtë drejtim, është tejet e rëndësishme që komunat të jenë aktive në ofrimin e masave për lehtësimin e vijimit të shkollimit në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Sa i përket edukimit parashkollor, komunat duhet të ndërmarrin masa për lehtësimin e regjistrimit për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian. Ndërkaq, meqenëse një ndër arsyt kryesore të braktisjes së shkollimit nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është gjendja e vështirë socio-ekonomike, komunat duhet të ofrojnë mbështetje/sigurojnë blerjen e pakove shkollore, teksteve shkollore, ofrimin e transportit për ata që banojnë larg objekteve shkollore, organizimin e mësimin plotësues, ofrimin e bursave e të tjera. Për më shumë, me qëllim që të rritet niveli i tyre i kualifikimit, e që do të ndihmonte në punësimin e tyre, komunat duhet të ofrojnë programe intenzive për pjesëtarët e këtyre komuniteteve, për përfundimin e arsimit të detyrueshëm, përkatësisht arsimit fillor dhe të mesëm të ulët.

Në anën tjetër, duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm të Qendrave Mësimore në përfshirjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim, përkrahja institucionale në nivel qendror dhe lokal është tejet e rëndësishme për rritjen e përfshirjes së fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parashkollor dhe arsimin parafillor. Në vijim janë ofruar disa rekomandime lidhur me qendrat mësimore:

- Donatorët dhe institucionet në nivel qendror dhe lokal duhet t'i përkrahin më fuqishëm dhe vazhdimisht Qendrat Mësimore, në mënyrë që ato të mund të pasurojnë aktivitetet e tyre dhe të rrisin numrin e fëmijëve dhe nxënësve që përfitojnë nga shërbimet e ofruara nga këto qendra.
- Institucionet lokale, qendrore dhe donatorët, duhet t'i përkrahin Qendrat Mësimore në mënyrë që të rrisin kapacitetet dhe cilësinë e punës së tyre me fëmijë në nivelin e edukimit parashkollor.
- Donatorët dhe institucionet lokale e qendrore duhet t'i përkrahin Qendrat Mësimore që të rrisin kapacitetet e tyre profesionale, në mënyrë që puna në Qendra Mësimore të jetë sa më profesionale.
- MASHT duhet të zbatojë kornizën ligjore për funksionimin e Qendrave Mësimore, përkatësisht Udhëzimin Administrativ Nr.12/2017 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore.
- Donatorët dhe organizatat jo-qeveritare duhet të mbështesin organizimin e trajnimeve për zhvillimin e kapaciteteve të personelit të Qendrave Mësimore dhe mësimdhënësve dhe këto trajnime duhet të përqendrohen në drejtësinë shoqërore dhe gjithëpërfshirjen sociale me qëllim të eliminimit të formave të diskriminimit.
- Institucionet lokale në bashkëpunim me organizatat jo-qeveritare duhet të funksionalizojnë ekipet për parandalim dhe reagim në rast të braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë duke siguruar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Qendrave Mësimore në këto ekipe.
- Organizatat jo-qeveritare që menaxhojnë Qendrat Mësimore duhet të luajnë rol pro-aktiv në shmangien e rasteve të dyfishimit të burimeve, ndërsa të gjitha palët, duke përfshirë edhe donatorët, duhet të kujdesen që të mënjanohet shpërndarja disproporcionale e burimeve në Qendra Mësimore.
- Institucionet lokale në bashkëpunim me organizatat jo-qeveritare duhet të sigurojnë transportin dhe ushqimin për të gjithë fëmijët që vijnë në mësimin shtesë dhe aktivitetet tjera në Qendra Mësimore.
- Organizatat jo-qeveritare duhet të iniciojnë aktivitete avokuese për të siguruar financim të rregullt nga buxheti shtetëror për Qendrat Mësimore dhe integrimin e tyre në sistemin arsimor të Kosovës.
- Stafi i Qendrave Mësimore duhet të mbledhin në mënyrë sistematike të dhëna dhe tregues lidhur me të arriturat arsimore të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë me qëllim të monitorimit të ndikimit të Qendrave Mësimore.
- Qendrat Mësimore duhet të rrisin bashkëpunimin e tyre me prindërit dhe komunitetin në mënyrë që të arrihet një ndikim më i madh në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e arsimit dhe përfshirjes sociale.

Përveç nivelit jo të kënaqshëm të përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelet e edukimit parashkollor, arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të lartë, një shqetësim tjetër është suksesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë. Prandaj, me qëllim të përmirësimit të suksesit të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë dhe vijimit të shkollimit në nivelet më të larta të arsimit, shkollat duhet të ofrojnë mësim plotësues për nxënësit që kanë nevojë.

Për të nxitur vazhdimin e studimeve në arsim e lartë, komunat dhe institucionet e nivelit qendror duhet të ofrojnë më shumë bursa për studentët rom, egjiptian dhe ashkali. Në të njëjtën kohë, edhe shkollat duhet të jenë proaktive, duke organizuar fushata vetëdijësuese për prindërit, në mënyre që të rritet vetëdija për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve.

Për fund, niveli i lartë të papunësisë së pjesëtarëve të këtyre komuniteteve është për faktin që nuk kanë qasje në tregun e punës dhe për shkak të mungesës së shkollimit dhe aftësive profesionale, prandaj sa më i lartë arsimimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, aq më e larta gjasat për punësimin e tyre. Rrjedhimisht, rritja e punësimit do të përmirësonte produktivitetin ekonomik dhe do të zvogëlonte shpenzimet qeveritare për asistencë sociale.

Shtojca 1. Lista e shkollave të përfshira në hulumtim



KOMUNA E GJAKOVËS

Nr.	Shkolla	Niveli
1	Emin Duraku	SHFMU
2	Mustafa Bakija 1	SHFMU
3	Zekerija Rexha	SHFMU
4	Selman Riza	SHFMU
5	Zef Lush Marku	SHFMU
6	Haxhi Hoti	SHFMU
7	Ukshin Miftari	SHFMU
8	Deshmoret e Hereqit	SHFMU
9	Fan Noli	SHFMU
10	Engjell Gjoni	SHFMU
11	Hajdar Dushi	SHML - Gjimnaz
12	Nexhmedin Nixha	SHML - Teknik
13	Ganimete Terbeshi 5	Institucion parashkollor



KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

Nr.	Shkolla	Niveli
1	Selman Riza	SHFMU
2	Mihal Grameno	SHFMU
3	Minatori	SHML - Teknik



KOMUNA E PRIZRENIT

Nr.	Shkolla	Niveli
1	Leke Dukagjini	SHFMU
2	Mati Logoreci	SHFMU
3	Abdyl Frasheri	SHFMU
4	Ibrahim Fehmiu	SHFMU
5	Haziz Tola	SHFMU
6	Dy Deshmoret	SHFMU
7	Ardhmeria	SHFMU
8	Naim Kokollari Budakova	SHFMU
9	Gjon Buzuku	SHML - Gjimnaz
10	Ymer Prizreni	SHML - Ekonomi



KOMUNA E FERIZAJ

Nr.	Shkolla	Niveli
1	Tefik Canga	SHFMU
2	Ahmet Hoxha	SHFMU
3	Naim Frasheri	SHFMU
4	Faik Konica	SHML - Ekonomi
5	Pjetër Bogdani	SHML - Teknik



KOMUNA E LIPJANIT

Nr.	Shkolla	Niveli
1	Fehmi Adani	SHFMU
2	Zenel Hajdini	SHFMU
3	Ismail Luma	SHFMU
4	Haradin Bajrami	SHFMU
5	Adem Gllavica	SHML



KOMUNA E GRAÇANICËS

Nr.	Shkolla	Niveli
1	Miladin Mitic	SHFMU
2	Kralj Milutin	SHFMU
3	Gjimnazi I Shkencave Shoqërore	SHML - Gjimnaz
4	Shkolla e Mesme e Mjekesise	SHML - Mjekësi
5	Shkolla e mesme Ekonomi-Tregti	SHML - Ekonomi

